



**QKSS**

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

# NDIKIMI RUS NË KOSOVË NËN HIJET E MITIT DHE REALITETIT







**QKSS**

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

# **NDIKIMI RUS NË KOSOVË NËN HIJET E MITIT DHE REALITETIT**

**Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë**

**Autor: Elis Vllasi, Ph.D**

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

Të drejtat e pronësisë intelektuale mbrohen nga Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe Ligji Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër, pa lejen paraprake të botuesit.

**Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze.**

**Mohim i përgjegjësisë:** Ky hulumtim u sponsorizua përmes një Burse Fulbright, nga Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, dhe u realizua me asistencën e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (në rolin e institucionit nikoqir). Gjetjet, pikëpamjet dhe opinionet e paraqitura në këtë raport janë vetëm ato të autorit dhe nuk përfaqësojnë në asnjë mënyrë opinionet, pikëpamjet ose pozicionet e politikave të Departamentit të Shtetit të SHBA-ve - Programi Fulbright, Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, Institutit Purdue për Hulumtim të Politikave, ose Universitetit Purdue.

**NËNTOR 2020**

# Tabela e përmbajtjes

---

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>1</b>
<b>HYRJE</b>	<b>4</b>
Konteksti i Kosovës	6
<b>OBJEKTIVAT RUSE NË KOSOVË</b>	<b>8</b>
Rusia si alternativë ndaj Perëndimit	9
Serbia, një trampolinë rajonale për politikën e jashtme ballkaniketë Ruisë	11
<b>AKTORË TË MUNDSHËM NË SAGËN RUSE</b>	<b>16</b>
Kosovarët dhe shqiptarët	16
Serbët e Kosovës dhe Serbia	18
Institucionet ndërkombëtare	24
<b>SHTIGJET E NDIKIMIT</b>	<b>27</b>
Mungesa e stabilitetit elektoral	27
Mungesa e sovranitetit në zonat me shumicë serbe	29
Siguria kibernetike	30
Mungesa e besimit mes shoqërisë	32
Njohuritë për mediat	33
<b>KONKLUZIONE</b>	<b>36</b>
<b>REKOMANDIME</b>	<b>38</b>



# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

---

Një tis dykuptimësie mbështjell ndikimin rus në Kosovë. Në mesin e popullatës lokale ka nga ata që mendojnë se rusët janë përzier në gjithçka, kurse Rusinë e shohin si gogolin që ka sjellë çdo dështim politik në vend. Të tjerët, veçanërisht ata që veprojnë në kuadër të organizatave ndërkombëtare të pranishme në Kosovë, nuk shohin ndonjë kërcënim serioz nga Rusia, dhe nuk e vënë ujin në zjarr për fuqinë e ndikimit rus. Me gjasë, e vërteta mund të jetë diku në mesin e këtyre dy perceptimeve të skajshme për ndikimin rus në Kosovë. Por, në mungesë të ekzaminimit sistemik të shkallës së ndikimit rus në vend, rreziku i vërtetë qëndron pikërisht në këtë pikë të mesit të mbingarkuar me dykuptimësi.

Studime të mëhershme tregojnë se ndikimi rus në Ballkanin Perëndimor varet nga konteksti. Ai bazohet në disa faktorë: 1) lidhjet etno-fetare (popullata sllave që i përket besimit të krishterë ortodoks); 2) varësia nga hidrokarburet (gazi natyror dhe nafta); 3) kapja e shtetit; dhe 4) përçarjet dhe konfliktet e brendshme. Për më tepër, ndikimi rus në Ballkanin Perëndimor shprehet në dy forma (dashamirëse dhe armiqësore). Me popullatën sllave dhe/ose ortodokse, Rusia është munduar të ndërtojë marrëdhënie që ngrihen mbi ndjenjat vëllazërore, duke u thirrur në lidhjet e përbashkëta historike dhe etno-fetare. Ajo i josh popullatat lokale dhe qeveritë drejt zhvillimit të marrëdhënieve më të ngushta.

Sidoqoftë, Kosova paraqet një rast të pazakontë, pasi nuk i përshtatet këtij përshkrimi të përgjithshëm të mënyrës si e shtrin Rusia ndikimin e saj në Ballkanin Perëndimor. Për dallim nga raportet me vendet e tjera të rajonit, Rusia as nuk e njeh Kosovën, as nuk ofron ndonjë alternativë ndaj integritetit Euro-Atlantik. Përkundrazi, ndikimi rus në Kosovë është armiqësor, duke qenë se aty përballet me një popullatë që nuk e përfill joshjen. Rusia nuk mundohet t'i drejtohet kësaj popullate duke u thirrur në lidhjet etno-fetare, sepse kosovarët janë shqiptarë etnikë (popull jo sllav) dhe myslimanë laikë në shumicën dërrmuese. As nuk mund të thirret në historinë e përbashkët, pasi Rusia ka qenë kahera aleate e Serbisë. Rusia nuk mund ta shfrytëzojë ndikimin ekonomik, duke qenë se ekonomia e Kosovës nuk bazohet në gazin natyror, madje as nuk ka investime ruse mes investimeve të huaja direkte në Kosovë. Në fakt, Rusia shkon në drejtimin e kundërt, sepse popullin kosovar në vend që ta joshë e shpërfill, ndërsa shtetin as që e ka në plan ta njohë, por ta dobësojë dhe shkatërrojë. Në Kosovë, Rusia përballet me një popull që ushqen ndjenja të pashembullta të dashamirësisë për Shtetet e Bashkuara dhe kulturën perëndimore, dhe me një shtet me aspirata të palëkundshme për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe NATO.

Për dallim nga veprimi në pjesët e tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore, përfshirë edhe në Ballkanin Perëndimor, në Kosovë objektivat strategjike të Ruisë janë të dyfishta. Synimi i parë, në nivel ndërkombëtar, është promovimi i interesave të veta gjeopolitike kundër Perëndimit. Për rusët, Kosova shërben për të dëmtuar zgjerimin e SHBA-ve dhe BE-së në rajon. Nëse SHBA-të dhe BE-ja nuk mund të kenë sukses në Kosovë, ato nuk do të mund të kenë sukses askund tjetër. Synimi i dytë, në nivelin rajonal, është krijimi i një trampoline në Serbi përmes secilës Rusia donë të ushtroj politikën e jashtme në Ballkan. Për këtë arsye, Rusia e përdor Kosovën për pazaret me Serbinë. Në këmbim të ndihmës ruse për promovimin dhe mbrojtjen e pretendimeve serbe ndaj Kosovës, , Serbia i siguron Ruisë një trampolinë në tokat e populluara me serbë dhe një politikës

të jashtme të koordinuar. Për këtë arsye, në Kosovë Rusia synon:

- Ta pengojë/diskreditojë zgjerimin e NATO-s dhe integrimin në BE;
- Të ndërtojë imazhin e Rusisë si një fuqi globale dhe të ofrojë një alternativë ndaj Perëndimit;
- Ta përdorë Kosovën për pazaret e veta me SHBA-të/BE-në për arritjen e ujdive në hapësirën ish Sovjetike;
- Ta ketë në dorë Serbinë duke promovuar dhe mbrojtur pretendimet e Serbisë ndaj Kosovës.

Në Kosovë, Rusia mund të llogarisë në qeverinë e Serbisë për t'i përdorur serbët etnikë si aktorë që më me dëshirë dhe gatishmëri i ekzekutojnë planet ruse, për shkak të lidhjeve të tyre historike dhe nevojës politike të lidhur me veton ruse ndaj anëtarësimit të Kosovës në OKB. Cilat janë shtigjet e ndikimit rus në lidhje me Kosovën? Në nivelin global, Rusia përdor fuqinë e saj diplomatike, ekonomike dhe ushtarake që t'i nxjerrë nga binarët proceset e shtetndërtimit të iniciuara dhe të udhëhequra nga SHBA-të dhe BE-ja, si dhe të kontestojë shtetësinë e Kosovës. Rusia e përdor krejt arsenalin e saj për të parandaluar pjesëmarrjen ose anëtarësimin e Kosovës në shumë forume dhe institucione ndërkombëtare si anëtare e barabartë e komunitetit botëror, sigurimin e njohjeve nga vende të tjera dhe të një ulëseje në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Në nivelin kombëtar (brenda Kosovës), Rusia mbështetet në shfrytëzimin e dobësive institucionale dhe shoqërore. Mungesa e stabilitetit elektoral, mungesa e stafit të gjerë dhe të përhershëm të ekspertëve në ministritë dhe agjencitë kyçe, si dhe mungesa e koordinimit ndër-institucional, e dobësojnë aftësinë e qeverisë për reagim ndaj kërcënimeve ruse. Niveli i lartë i mosbesimit ndërshoqëror, së bashku me vetëdijësimin e përgjithshëm ultë sa i përket impaktit opinion-formues të medias, e dobëson reziliencën e popullatës përball manipulimeve.

Një nga sfidat e këtij hulumtimi ka qenë doza e fshehtësisë nën të cilën shqyrtohet kjo çështje nga qeveria e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare (në Kosovë). Kosova është një vend ku njerëzit mezi presin të flasin për ndikimin rus, por kur personave me njohuri rreth kësaj teme, si p.sh. zyrtarë të qeverisë, ligjvënës, zyra e Presidentit dhe zyra e Kryeministrit, u ofrohet mundësia të hedhin dritë mbi këtë çështje, ata zgjedhin të qëndrojnë të heshtur. Edhe disa organizata ndërkombëtare dhe përfaqësi diplomatike në Kosovë të akuzuara se janë të ndikuara nga rusët, zgjedhën të heshtin kur iu ofrua mundësia për intervistë.

Bazuar në intervistat e kryera dhe njohuritë e disponueshme përmes burimeve të hapura, ndikimi rus në Kosovë është i kufizuar, por i dëmshëm. Në Kosovë, rusët nuk kanë dorë të lirë të bëjnë si të duan, marrë parasysh mjedisin armiqësor në të cilin veprojnë, kështu që shumica e aktiviteteve të tyre drejtohen në nivelin global. Ndalimi i plotë i ndikimit rus brenda Kosovës mund të jetë i pamundur për sa kohë që Serbia ushtron sovranitetin e saj mbi zonat me shumicë serbe, veçanërisht në pjesën veriore të Kosovës. Sidoqoftë, institucionet vendase dhe komuniteti ndërkombëtar mund ta zmbropsin dhe frenojnë ndikimin armiqësor të Rusisë në vend duke zbatuar disa rekomandime.

Qeveria e Kosovës duhet:

1. Të forcojë institucionet shtetërore dhe koordinimin ndër-institucional;
2. Të kufizojë mungesën e stabilitetit elektoral;
3. Të krijojë një infrastrukture reziliente kibernetike;



4. T'ia komunikojë kërcënimet popullatës;
5. Të nxisë reziliencën mes popullatës përmes edukimit për njohuritë digjitale dhe për mediat.

Komuniteti ndërkombëtar do të duhej:

1. Ta ndërpresë promovimin e planeve politike që i mundësojnë Serbisë të ushtrojë sovranitetin mbi zonat me shumicë serbe në Kosovë;
2. Ta përgatisë Kosovën për anëtarësimin në NATO;
3. T'i edukojë dhe trajnojë, si dhe të bashkëpunojë dhe koordinojë me organizatat e sigurisë së Kosovës për luftën hibride duke përdorur praktikën më të mira nga shtetet baltike;
4. Të krijojë një Qendër Rajonale të Ekselencës për Mbrojtjen Hibride.

Ky hulumtim synon të shtojë njohuri të reja në punimet shumë të kufizuara shkencore që shqyrtojnë ndikimin e Ruisë në Kosovë. Ky punim duhet të shërbejë si pikë fillestare për hulumtime të mëtejshme shkencore mbi këtë çështje të rëndësishme. Faza vijuese e këtij hulumtimi do të përpiqet të shqyrtojë dobësitë e Kosovës ndaj ndikimit rus në domenin kibernetik.

# HYRJE

---

Pasojat e referendumit të vitit 2016 në Mbretërinë e Bashkuar për daljen nga Bashkimi Evropian (Brexit) dhe zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në Shtetet e Bashkuara (SHBA) e kanë nxjerrë në plan të parë të politikës ndërkombëtare çështjen e operacioneve të ndikimit rus. Befasia më e madhe nuk ishte përfshirja e Rusisë, por sa të papërgatitura ishin SHBA-të dhe Mbretëria e Bashkuar për t'iu kundërvënë këtyre sfidave. Në SHBA, ligjvënësit kyç republikanë as që donin të kishin lidhje me nismën e përbashkët të të dy partive për ta dënuar ndërhyrjen ruse, ndërkohë që administrata e Obamës ishte e shqetësuar se një përgjigje e fortë do të shihej si ndihmë ndaj fushatës presidenciale të Hillari Klintonit, kurse Donald Trumpi do të deklaronte se konstatimet e 17 agjencive të inteligjencës të SHBA-ve që tregonin ndërhyrjen ruse, janë të pasakta.<sup>1</sup> Edhe vetë publiku u tregua shumë i ndikueshëm nga manipulimi rus, me 47% të republikanëve që besonin se Rusia nuk qëndronte prapa ndërhyrjeve në zgjedhje.<sup>2</sup> Në rastin e Mbretërisë së Bashkuar dhe Brexit-it, një raport i vitit 2020 nga Komisioni Parlamentar për Inteligjencë dhe Siguri tregon se qeveria e Mbretërisë së Bashkuar e “nënvlerësoi keqazi” kërcënimin rus dhe refuzoi ta hetojë ndërhyrjen ruse. Këto dy raste të ndikimit rus ngrenë një pyetje të rëndësishme: nëse vendet më të përparuara të botës nuk i kuptojnë plotësisht objektivat, aktorët dhe shtigjet e ndikimit rus, madje nuk janë në gjendje të mbrohen në mënyrë efektive prej tij, si mund të shpresohet që vende më të vogla, si Kosova, ta zbërthej ndikimin rus brenda vendit?

Sipas Fjalorit të Oksfordit, ndikimi mund të përkufizohet si “aftësia e të pasurit efekt mbi karakterin, zhvillimin ose sjelljen e dikujt ose diçkaje, ose mbi vetë efektin”.<sup>3</sup> Individët, grupet dhe vendet mund të ushtrojnë ndikim në shkallë të ndryshme. Rrjedhojat e veprimeve të ndikimit mund të jenë të dyfishta, padëmshëm ose keqdashës. Ndikimi është padëmshëm nëse prej tij përfitojnë si ndikuesi ashtu edhe shteti i targetuar. Për ta bërë për vete një vend, ndikuesi i padëmshëm mund të mbështetet në sistemin e tij politik, modelin ekonomik, kulturën dhe rrjedhën e lirë të informacionit. Për shembull, prej fundit të Luftës së Ftohtë, SHBA-të dhe Bashkimi Evropian (BE) janë përpjekur të ndikojnë në drejtimin politik dhe ekonomik të vendeve, afër dhe larg. Duke promovuar demokratizimin dhe ekonominë e tregut të lirë në nivel të jashtëm, SHBA-të dhe vendet e BE-së janë përpjekur të përfitojnë nga sigurimi i aleatëve të rinj, duke krijuar tregje të reja, si dhe duke zvogëluar kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare. Ama, përvetësimi i modeleve perëndimore të zhvillimit politik dhe ekonomik ka sjellë përfitime edhe për vetë shtetet e synuara. Prej vitit 1990, vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL) kanë gëzuar paqe, liri, prosperitet ekonomik dhe stabilitet politik si rezultat i programeve të SHBA-ve dhe BE-së për liberalizim politik dhe ekonomik.<sup>4</sup>

---

1 Waddell, Kaveh. 2016. “Pse nuk i shpalosi Obama raportet e inteligjencës për ndikimin e Rusisë në zgjedhje?”. The Atlantic, 2016. <https://www.theatlantic.com/technology/archive/2016/12/why-didnt-obama-reveal-intel-about-russias-influence-on-the-election/510242/>.

2 Kiley, Jocelyn. 2017. “Publiku i SHBA-ve e dallon rolin rus në hakimin e fushatës, por është i përçarë kur flitet për sanksione të reja.” Pew Research Centre. 10 janar 2017. <https://www.pewresearch.org/fact-tank/2017/01/10/u-s-public-says-russia-hacked-campaign/>.

3 “Përkufizimi i ndikimit nga Fjalori i Oksfordit.” pa datë Fjalorët Lexico. Qasur më 21 shtator 2020. <https://www.lexico.com/definition/influence>.

4 Lagon, M. P. (2011). Promovimi i demokracisë: Pse-të dhe si-të për Shtetet e Bashkuara dhe komunitetin ndërkombëtar. Këshilli për Marrëdhënie të Jashtme. Sedaca, N. B., & Bouchet, N. (2014). A po mbahet fort?: Promovimi i demokracisë nga SHBA-të në një botë në ndryshim. Londër: Chatham House.

Ndikimi mund të jetë keqdashës nëse prej tij përfiton vetëm vendi që e ushtron dhe dëmtohet vendi i targetuar. Ndikuesi keqdashës mbështetet në mjete si “propaganda, dezinformimi, keqinformimi dhe keqformimi”<sup>5</sup> (PDKK) për ta manipuluar një kundërshtar drejt ndërmarrjes së një grupi veprimesh dhe politikash të paracaktuara. Në kontekste të caktuara, një shtet mund të angazhohet edhe në “luftë ndikimi” duke e integruar PDKK me “vrasje, represion politike dhe aktivitete të tjera që minojnë mbështetjen popullore për qeveritë”.<sup>6</sup> Ndikuesi keqdashës nuk synon ta promovojë, por ta imponojë sistemin e vet politik/ekonomik mbi shtetin e targetuar.

Rusia është shembull i përkryer i një ndikimi të tillë keqdashës ose armiqësor. Që kur Bashkimit Sovjetik i erdhi fundi, Rusia i ka përqendruar operacionet e saja të ndikimit kryesisht drejt dy rajoneve strategjike. I pari përfshin hapësirën ish Sovjetike ose vendet fqinje, dhe konsiderohet rajoni kryesor strategjik i Rosisë. Në këtë rajon Rusia është përpjekur ta ruajë pozicionin e saj dominues duke përdorur kërcënime politike, shtrëngim ekonomik, dhe forcë të armatosur kur i është dashur (p.sh., Gjeorgjia, Moldavia dhe Ukraina). Ballkani paraqet rajonin e dytë më të rëndësishëm gjeostrategjik për politikën e jashtme të Rosisë.<sup>7</sup> Rajoni “[ka] qenë historikisht një nga pikat më të rëndësishme të fokusit të politikës së jashtme, ndikimeve kulturore dhe përpjekjeve ruse për përhapjen e një ideologjie të solidaritetit ortodoks dhe reciprocitetit sllav.”<sup>8</sup> Sidoqoftë, ndryshe nga hapësira ish Sovjetike, Ballkani ka shërbyer si fushëbetëj ku rusët kusuriteshin me perandoritë e tjera (p.sh. Perandoritë Austro-Hungareze dhe Osmane) që janë shtyrë për ndikim në këtë rajon përgjatë shekujve. Është ky kontekst i larjes së hesapeve perandorake në të cilin duhet ta shqyrtojmë dhe të përpiqemi ta kuptojmë ndikimin rus, veçanërisht në Kosovë.

Pasojat e shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe mungesa e stabilitetit të brendshëm në Kaukaz e detyruan politikën e jashtme të Rosisë në fillimin e viteve 1990 të “qëndronte brenda atyre që mund të quhen parametrat e konsensusit ndërkombëtar”,<sup>9</sup> megjithatë, lufta në Kosovë dhe konsolidimi politik nën Presidentin Vladimir Putin e ripërtërinë qasjen tradicionale ruse prej “prishësi” në lidhje me Ballkanin. Prej vitit 1999, rusët kanë qenë shumë aktivë në të gjithë ish Jugosllavinë, duke gënjerruar destabilizim dhe konflikte.

Në Bosnjë, rusët kanë punuar fort për dobësimin e shtetit të përbashkët dhe për forcimin e Republikës Serbe (Republika Srpska, RS) si mjet që nuk i lejon Bosnjës të anëtarësohet në NATO, për ta mbajtur Bosnjën si një shtet të dështuar, dhe potencialisht për të fituar një trampolinë në këtë vend përmes instalimit të një baze ushtarake.<sup>10</sup> Gjatë disa viteve të fundit, Rusia ka armatosur forcën paramilitare të RS-së, duke siguruar trajnim për policinë e RS-së dhe grupin paramilitar serb Nderi Serb.<sup>11</sup> Në Maqedoninë e Veriut, “spiunët dhe diplomatët rusë janë përfshirë në përpjekje gati dhjetëvjeçare për përhapjen e propagandës dhe provokimin e përçarjeve...

5 Wardle, Claire, dhe Hossein Derakhshan. 2017. “Çrregullimi i informacionit: Drejt një kornize ndërdisiplinore për hulumtime dhe politikëbërje (Raporti i Këshillit të Evropës DGI (2017) 09).” Strasbourg Cedex: Këshilli i Evropës. <https://rm.coe.int/information-disorder-report-november-2017/1680764666>.

6 Dhunjishah, Kolonel Michael G. 2017. “Grupi Punues për Masa Aktive: Prologu është e shkuara.” Projekti për Hulumtim të Strategjisë. Kolegji i Luftës i Ushtrisë së SHBA-ve. <https://publications.armywarcollege.edu/pubs/3414.pdf>.

7 Hoxhaj, Enver. Intervistë me Elis Vllasin. Intervistë personale. Prishtinë, 22 janar 2020.

8 Sotirovic, Vladislav B. 2016. “Rusia Cariste dhe Ballkani.” The Baltic Review, 24 mars 2016. <https://baltic-review.com/tsarist-russia-balkans/>.

9 Bowker, Mike. 1998. “Luftërat në Jugosllavi: Rusia dhe Komuniteti Ndërkombëtar.” Studime Evropë-Azi 50 (7): 1245–61.

10 Rujević, Nemanja. 2019. “Gara e armatimit në Ballkan - Rusia dëshiron një bazë ushtarake në RS.” Deutsche Welle. 1 gusht 2019. <https://www.dw.com/bs/trka-u-naoru%C5%BEanju-na-balkanu-rusija-%C5%BEeli-voynu-bazu-u-rs-u/a-49828674>.

11 Borger, Julian. 2018. “Dërgesa e armëve për serbët e Bosnjës ngjall frikën në BE.” The Guardian, 13 shkurt 2018. <http://www.theguardian.com/world/2018/feb/13/bosnian-serb-police-arms-purchase-stokes-eu-fears>.

si pjesë e një përpjekjeje në mbarë rajonin për të ndaluar anëtarësimin në NATO të vendeve të Ballkanit”.<sup>12</sup> Kurse në Malin e Zi, pasi nuk arritën të marrin miratimin e qeverisë për një port detar për “furnizimin dhe riparimin e anijeve ushtarake ruse”, dhe të vendosur që të mos lejonin anëtarësimin e këtij vendi në NATO, agjentët rusë të GRU-së dhe FSB-së komplotuan pa sukses përmbysjen e dhunshme të qeverisë natën e zgjedhjeve më 16 tetor 2016. Hetimi i komplotit tregoi se “agjentët rusë, ekstremistët serbë dhe udhëheqësit e aleancës së opozitës malazeze (Fronti Demokratik) u përgatitën për rrëzimin e qeverisë... [duke] nxitur dhunë politike me shpresën që do të shkaktoheshin protesta në mbarë vendin që do ta rrëzonin Qeverinë e Partisë Demokratike të Socialistëve (DPS) të udhëhequr nga Milo Gjukanoviç.”<sup>13</sup>

## Konteksti i Kosovës

Literatura e gjerë për ndikimin rus në Evropën Qendrore dhe Lindore<sup>14</sup> i ka të pakta faqet që flasin për Kosovën në mënyrë të posaçme. Rasti i Kosovës është unik në shumë mënyra, pasi nivelet e operacioneve të Rosisë, aktorët tek të cilët ajo mbështetet për t’i kryer operacionet e saj të ndikimit, dhe mjetet që përdor për ta ekzekutuar ndikimin e saj, ndryshojnë nga ato të përdorura në rajon. Për ta shtrirë ndikimin e saj në vende të tjera, Rusia mund të mbështetet në lidhjet etno-fetare, historinë e përbashkët, shitjet e naftës dhe gazit, investimet e huaja direkte, ose kapjen e shtetit, kurse në Kosovë nuk e ka mundësinë: të thirret në lidhjet etno-fetare për të fituar vullnet të mirë mes popullatës shumicë të vendit; të mbështetet në instrumentet ekonomike, pasi ekonomia nuk bazohet në gaz natyror dhe nuk ka investime të huaja direkte ruse; të fitojë mbështetjen e elitave politike, pasi ato janë pro-përendimore dhe anti-ruse.

Mungesa e ndikimit Rus në Kosovë nuk nënkupton mungesë interesi ose aftësie për të trazur. Rusia ka qenë e pranishme në Kosovë shumë kohë para se trupat ushtarake ruse ta okuponin Aeroportin e Prishtinës nën hijen e natës në qershor të vitit 1999. Në vitin 1903, “për të marrë informacion të vërtetë mbi vuajtjet e popullit serb” Rusia emëroi Gregori Stepanoviç Sherbina si konsull në Mitrovicë gjatë viteve të fundit të pranisë osmane në Ballkan.<sup>15</sup> Sherbina, si bashkatdhetarët e tij pothuajse një shekull më vonë, “u mirëprit si shpëtimtar... [atje, për ta] shpëtuar popullatën serbe

12 Belford, Aubrey, Saska Cvetkovska, Biljana Sekulovska, dhe Stevan Dojčinović. 2017. “Dokumentet e rrjedhura tregojnë përpjekjet ruse dhe serbe për t’u përzier në Maqedoni.” Projekti i Raportimit të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit. 4 qershor 2017. <https://www.occrp.org/en/spooksandspin/leaked-documents-show-russian-serbian-attempts-to-meddle-in-macedonia/>

13 Bajrović, Reuf, Vesko Garčević, dhe Richard Kraemer. 2018. “Në fije të perit: Strategjia ruse e destabilizimit në Malin e Zi.” Instituti i Hulumtimeve të Politikës së Jashtme. <https://www.fpri.org/article/2018/07/hanging-by-a-thread-russias-strategy-of-destabilization-in-montenegro/>.

14 Psh., CSD. 2019. “Ndikimi ekonomik i Rosisë në Ballkan: Ndërhyrja ndaj fuqisë së mprehtë të Kremlinit.” Punim informativ për politikën nr. 89. Sofje: Qendra për Studimin e Demokracisë. <https://csd.bg/publications/publication/policy-brief-no-89-russias-economic-influence-in-the-balkans-tackling-kremlins-sharp-power/>; CSD. 2018. “Gjurma ekonomike ruse në Ballkanin Perëndimor. Risqet e korrupsionit dhe kapjes së shtetit.” Sofje: Qendra për Studimin e Demokracisë. <http://old.csd.bg/artShow.php?id=18228>; Bieber, Florian, dhe Nikolaos Tzifakis. 2019. “Ballkani Perëndimor si fushë shahu gjeopolitike? Mitet, realitetet dhe opsionet e politikave.” BiEPAG, Punim informativ për politikën, qershor 2019. <https://ssrn.com/abstract=3406295>; Galeotti, Mark. 2018. “A përballet Ballkani Perëndimor me një stuhi ruse në ardhje?” ECFR/250. Këshilli Evropian për Marrëdhënie të Jashtme. [https://www.ecfr.eu/publications/summary/do\\_the\\_western\\_balkans\\_face\\_a\\_coming\\_russian\\_storm](https://www.ecfr.eu/publications/summary/do_the_western_balkans_face_a_coming_russian_storm); Stronski, Paul, dhe Annie Himes. 2019. “Loja e Rosisë në Ballkan”. Fondacioni Carnegie për Paqen Ndërkombëtare. <https://euagenda.eu/upload/publications/untitled-203333-ea.pdf>

15 “Në Kosovë përkujtohet 110 vjetori i vdekjes së konsullit rus Gregori Sherbina.” 2013. Fondacioni Bota Ruse. 2 prill 2013. <https://russkiymir.ru/en/news/131776/>.

nga tirania e shqiptarëve”.<sup>16</sup> Sidoqoftë, roli i konsullit nuk ishte të mblidhte fakte por të ndikonte në situatën politike që kishte lindur nga vuajtjet e popullatës në Kosovë. Sipas burimeve serbe që përshkruajnë trazirat e marsit 1903 “konsulli rus, kalëronte i veshur me uniformë kozaku kur patrullonte vijën e parë të mbrojtjes, duke i inkurajuar mbrojtësit [serbë] të mos dorëzoheshin... [dhe] i shoqëruar nga disa oficerë dhe policë turq” të shqetësuar nga sulmet e shqiptarëve.<sup>17</sup> Hyrja perfide e trupave ruse në Kosovë përpara forcave të NATO-s në vitin 1999 dhe ndikimi i vazhdueshëm i Rusisë duhet të shërbejë si përkujtesë se “është gabim të mendosh se Rusia u rikthye në Ballkan, pasi Rusia nuk i ka braktisur kurrë interesat e saja në Ballkan.”<sup>18</sup>

Ndikimi i Rusisë në Kosovë mund të interpretohet si keqdashës (armiçësor). Ajo nuk synon të mbështesë lidhje më të ngushta me popullatën kosovare apo të promovojë ideologjinë e saj politike/ekonomike, as ta fusë Kosovën në sferën e saj të ndikimit duke i ofruar ndihmë ekonomike, mbështetje politike, ndihmë ushtarake ose anëtarësim në institucionet rajonale të drejtuara nga Rusia, siç janë Organizata e Traktatit të Sigurisë Kolektive (CSTO) dhe Komuniteti Ekonomik Euroaziatik (EurAsEC). Fakti që Rusia nuk përpiket ta fitojë Kosovën, e kufizon atë që mund të arrijë për sa i përket ndikimit.

Një faktor tjetër kufizues për ndikimin rus në Kosovë është prania e ngulitur e SHBA-ve dhe BE-së. Forca e Kosovës e udhëhequr nga NATO-ja (KFOR), aktualisht përfshin 3,532 trupa nga 27 kombe<sup>19</sup> dhe është përgjegjëse për sigurinë e jashtme të vendit, ndërkohë që organizata të ndryshme ndërkombëtare promovojnë demokratizimin dhe ekonominë e tregut të lirë si mënyrë për të ndikuar në drejtimin e shtetndërtimit të Kosovës. Kosova është atëherë “plotësisht e amerikanizuar, sa që Rusia mundet vetëm të shpresojë të jetë përçarëse. Ajo nuk do të ketë kurrë shumë ndikim në vend.”<sup>20</sup> Shumica dërmuese e popullatës ka përqafuar kulturën perëndimore, kapitalizmin dhe demokracinë, dhe Kosova është “ndoshta vendi më pro-amerikan në botë”.<sup>21</sup> Një anketë e vitit 2020 nga Instituti Republikan Ndërkombëtar konstatoi se pothuajse të gjithë kosovarët (94 për qind) i përmendën Shtetet e Bashkuara si partnerin më të rëndësishëm politik dhe ekonomik të vendit të tyre,<sup>22</sup> kurse “shumica dërmuese (93 për qind) mbështesin anëtarësimin në BE”.<sup>23</sup>

16 Vujovic, Miso. pa datë. “Një viktimitë e ndjenjave fisnike”. Revista Kombëtare Serbe. Qasur më 21 shtator 2020. <http://www.nacionalnarevija.com/en/tekstovi/br5/Prijatelj%20-%20Grigorij%20Stepanovic%20Scerbina.html>.

17 Po aty.

18 Hoxhaj, Enver. Intervistë me Elis Vllasin. Intervistë personale. Prishtinë, 22 janar 2020.

19 NATO. 2020. “Faktet dhe shifrat kyçe të Forcës së Kosovës (KFOR)”. Shkurt 2020. [https://www.nato.int/nato\\_static\\_fl2014/assets/pdf/2020/2/pdf/2020-02-KFOR-Placemat.pdf](https://www.nato.int/nato_static_fl2014/assets/pdf/2020/2/pdf/2020-02-KFOR-Placemat.pdf).

20 Anonim (këshilltar perëndimor i Qeverisë së Kosovës). Intervistë me Elis Vllasin. Prishtinë, 4 shkurt 2020.

21 Sullivan, Stacey. pa datë. “Obsesioni i Kosovës me Amerikën”. Time.Com. <https://time.com/kosovo-independence-america-obsession/>.

22 Instituti Republikan Ndërkombëtar. 2020. “Anketa e Ballkanit Perëndimor tregon mbështetje të fortë për BE-në.” Instituti Republikan Ndërkombëtar. <https://www.iri.org/resource/western-balkans-poll-shows-strong-support-eu>.

23 Po aty.

# OBJEKTIVAT RUSE NË KOSOVË

Tradicionalisht, Rusia ka dislokuar trupa ushtarake dhe trupa speciale apo siç njihen ndryshe 'burra të vegjël të gjelbër' në të gjithë hapësirën ish Sovjetike për të fituar kontrollin e territoreve të populluara nga rusë etnikë. Kohët e fundit, Rusia po ndjek në mënyrë aktive Doktrinën Gerasimov, duke u mbështetur në "përdorimin e gjerë të masave politike, ekonomike, informative, humanitare, dhe masave të tjera jo ushtarake, të zbatuara duke përdorur potencialin për protesta të popullatës... [për] arritjen e qëllimeve politike dhe strategjike, masa të cilat në disa raste dukshëm tejkalojnë forcën e armëve në efektivitetin e tyre."<sup>24</sup> Rusia ka përdorur oligarkë, gazetarë, akademikë, ekspertë dhe klerikë për t'u përfshirë në operacione ndikimi, nga Britania e Madhe në Ukrainë, dhe nga Finlanda deri në Greqi.

Teksa është e kuptueshme pse Rusia zhvillon politika për kontrollin e zonave të populluara nga rusë etnikë në ish republikat Sovjetike ose e manipulon publikun për vendime për avancimin e politikave të saja të jashtme dhe të sigurisë, rëndësia e Kosovës për politikën e jashtme të Rusisë të bën të mendohesh. Fundja, Kosova është e vogël, e varfër, pa ndonjë vlerë strategjike topografike,<sup>25</sup> dhe pa diasporë ruse.

Në Kosovë, ndikimi i Rusisë ka për qëllim përbushjen e dy objektivave të gjera gjeostrategjike, nga njëra anë ofrimin e një alternativë ruse ndaj Perëndimit, kurse nga tjetra kapjen e një trampoline në Serbi (si fizikisht ashtu edhe në harmonizimin e politikës së jashtme të Serbisë me atë të Rusisë). Politikanët e lartë kosovarë dhe serbë e shohin ndikimin rus si pjesë të lojës gjeopolitike të stilit të shekullit 21. Rusët nuk janë në Kosovë sepse ju intereson vetë vendi, por për ta synuar Ballkanin në tërësi. Teksa "interesat dhe aftësitë e Rusisë janë rritur, kështu është rritur edhe niveli i tyre i përfshirjes" në rajon, sipas zëvendës Kryeministrit të Kosovës, Enver Hoxhaj.<sup>26</sup> Ish-Ministri i Ekonomisë i Serbisë beson se "Serbia dhe pjesa tjetër e Ballkanit janë gur shahu në lojën mes fuqive të mëdha, Rusisë, BE-së dhe SHBA-ve".<sup>27</sup> Si pasojë e luftës së Kosovës, Kosova është kthyer në një farë mënyre në Berlinin e shekullit 21, një vatër e spiunazhit dhe intrigës, në të cilën fuqitë globale dhe rajonale (p.sh. SHBA-të, BE-ja, Rusia, Turqia, Serbia) shtyhen dhe konkurrojnë për ndikim dhe që të promovojnë, mbrojnë ose imponojnë interesat e tyre.

Politikanët ballkanikë nuk janë të vetmit që e kuptojnë vlerën e konkurrencës gjeostrategjike në rajon. Ka dëshmi të gjera për këtë edhe në literaturën shkencore dhe atë politike. Në shqyrtimin e tij të "mendimit dhe perceptimit aktual mbi [ndikimin rus] mes shërbimeve sekrete perëndimore" Hågen Karlsen konstaton se Rusia mbështetet në ndikimin e saj në mënyrë që të ruajë sigurinë e regjimit të shtetit rus, të mbizotërojë në rajonin e fqinjësisë së Rusinë, dhe që ta dobësojë NATO-n.<sup>28</sup> Përveç parandalimit të zgjerimit të NATO-s<sup>29</sup>, Rusia synon edhe ta dobësojë BE-në, duke qenë

24 Gerasimov, Valery. 2013. "Vlera e shkencës në parashikim". VPK News. 26 shkurt 2013. <https://www.vpk-news.ru/articles/14632>.

25 I mungon qasja në Detin Adriatik, dhe nuk ndodhet në kryqëzimin e tubacioneve të naftës dhe gazit.

26 Hoxhaj, Enver. Intervistë me Elis Vllasin. Intervistë personale. Prishtinë, 22 janar 2020.

27 Prothero, Mitch. 2017. "Të gjithë sytë janë mbi Ballkan teksta bota tërhiqet". BuzzFeed News. 19 mars 2017. <https://www.buzzfeednews.com/article/mitchprothero/all-eyes-are-on-the-balkans-as-the-world-retreats>.

28 Karlsen, Geir Hågen. 2019. "Përça dhe sundo: Dhjetë mësimet rreth aktiviteteve të ndikimit politik rus në Evropë." Palgrave Communications 5 (1): 1-14. <https://www.nature.com/articles/s41599-019-0227-8>.

29 Bechev, Dimitar. 2019. "Interesat strategjike dhe mjetet e ndikimit të Rusisë në Ballkanin Perëndimor". Qendra e Ekselencës për Komunikim Strategjik e NATO-s. <https://www.ceeol.com/search/book-detail?id=856030>.

se ajo “beson fuqimisht se zgjerimi i BE-së në Ballkan sjell një avantazh pervers... [pasi] anëtarësimi i mundshëm i vendeve të reja dhe më të varfra do të krijojë në mënyrë të pashmangshme kërkesa të mëtejshme për burimet e përbashkëta dhe më shumë ndasi mes bllokut”.<sup>30</sup> Shpjegime të tjera gjeostrategjike që janë ofruar përfshijnë: Rusia synon të zgjerohet ndikimin e saj global në kurriz të SHBA-ve;<sup>31</sup> të “pozicionohet si rrugëhapëse drejt pushtetit” në rajon në mënyrë që të mund ta shfrytëzojë pozicionin e saj në Ballkan për koncesione nga SHBA-të dhe BE-ja në vende si Ukraina dhe Gjeorgjia, ose që të parandalojë anëtarësimin në NATO të vendeve të Ballkanit Perëndimor.<sup>32</sup>

## Rusia si alternativë ndaj Perëndimit

Studimet për ndikimin rus në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL), veçanërisht në Ballkanin Perëndimor, janë përgjithësisht në harmoni në lidhje me objektivat e lartpërmendura strategjike që Rusia synon të arrijë. Por shumë prej këtyre studimeve nuk ia dalin të adresojnë pyetjen pse Rusia po e kërkon gjithnjë e më shumë konfrontimin me NATO-n dhe BE-në, veçanërisht në Ballkan. Disa studime<sup>33</sup> kanë sugjeruar se zgjerimi i NATO-s drejt Lindjes e bën Rusinë të pasigurt, dhe ndoshta kjo është arsyeja pse Rusia po konfrontohet me SHBA-të dhe BE-në në të gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore, përfshirë edhe në Kosovë. Kjo mundet fare lehtë të jetë një nga arsyet pse Rusia synon të kundërveprojë ndaj SHBA-ve dhe BE-së në Kosovë, por nuk është e vetmja arsye. Ashtu siç ka ndryshuar fati i Rosisë që nga shpërbërja e Bashkimit Sovjetik, ashtu ka ndryshuar edhe oreksi i saj që të pozicionohet si model alternativ ndaj Perëndimit. Rusia ka tentuar historikisht ta promovojë ‘civilizimin rus’ si antitezë ndaj liberalizmit evropian. Agresioni ushtarak rus në ish republikat Sovjetike, por edhe në Siri dhe Libi (prej vitit 2011), “përbën një komponent të një agjende më të gjerë strategjike për rindërtimin e një blloku me Moskën në qendër, i krijuar për të konkurruar me Perëndimin... në të cilin Moska dominon Euroazinë dhe gjysmën e Evropës”<sup>34</sup> sipas Janusz Bugajskit, një prej studiuesve kryesorë të politikës së jashtme ruse. Ballkani, përfshirë Kosovën, paraqet mundësinë më të mirë, jashtë ish republikave Sovjetike, që Rusia të shpërfaqë alternativën e saj duke e shtyrë në pozita mbrojtëse zgjerimin e BE-së dhe NATO-s.

Alternativa ruse ndaj rendit liberal perëndimor është diskutuar dhe promovuar nga një elitë e larmishme intelektualësh përgjatë një shekulli të tërë. Ivan Iljin, në shkrimet e tij mes viteve 1920-1950, e përfytyronte Rusinë si një shtet Krishtero-fashist që sundohej nga një dorë e hekurt. Teoria e Iljinit bazohej në konceptin se “bota ishte e korruptuar; kishte nevojë për shëlbim nga një komb i aftë për politikë totale; ai komb ishte Rusia e panjollësor.”<sup>35</sup> Këtë teori pothuajse të harruar, elitat

30 Galeotti, A përballet Ballkani Perëndimor me një stuhi ruse në ardhje?

31 Stronski, Paul, dhe Richard Sokolsky. 2017. “Rikthimi i Rosisë globale: një kornizë analitike”. Punim informativ. Fondacioni Carnegie për Paqen Ndërkombëtare. <https://carnegieendowment.org/2017/12/14/return-of-global-russia-analytical-framework-pub-75003>.

32 IISS. 2019. “Rusia dhe Ballkani Perëndimor”. IISS. Qershor 2019 <https://www.iiss.org/publications/strategic-comments/2019/russia-and-the-balkans>.

33 Psh., Black, Joseph L. 1999. “Rusia dhe zgjerimi i NATO-s drejt lindjes: vija e kuqe tek shtetet baltike.” *International Journal* 54 (2): 249–66; Russett, Bruce, dhe Allan C Stam. 1998. “Ndjellja e katastrofës: NATO-ja e zgjeruar kundër Rosisë dhe Kinës.” *Political Science Quarterly* 113 (3): 361–82; Mandelbaum, Michael, Susan Eisenhower, Jack Mendelsohn, dhe Jonathan Dean. 1998. “Arsyet kundër zgjerimit të NATO-s”. *Current History* 97 (617): 132; Barany, Zoltan. 2002. “Zgjerimi i NATO-s, raundi i dytë: përkeqësimi i punëve”. *Studime të Sigurisë* 11 (3): 123–57.

34 Bugajski, Janusz, dhe Margarita Assenova. 2016. Përçarja Euroaziatike dhe krahët e cenueshëm të Rosisë. Uashington, D.C.: Fondacioni Jamestown. <https://jamestown.org/product/eurasian-disunion-russias-vulnerable-flanks/>.

35 Snyder, Timothy. 2018. “Ivan Iljin, Filozofi i Putinit për fashizmin rus”. *The New York Review of Books* (blog). 16 mars 2018. <https://www.nybooks.com/daily/2018/03/16/ivan-iljin-putins-philosopher-of-russian-fascism/>.

ruse të drejtuara nga Presidenti Putin filluan ta citojnë gjerësisht për të artikuluar vizionin e tyre për Rusinë, sipas Timothy Snyder. Iljin përmendet aq dukshëm në regjimin e Putinit, saqë është cilësuar si “Filozofi i Putinit” nga Anton Barbashin dhe Hanna Thorun.<sup>36</sup>

Në shkrimet e tij gjatë Luftës së Ftohtë, Aleksandër Solzhenicin, fitues i Çmimit Nobel dhe kritik i fortë i Bashkimit Sovjetik, paraqiti vizionin e tij për një Rusi të re. Vizioni i tij nuk ishte për një Rusi me ideale perëndimore në formën e vendit të tij të adoptuar, SHBA-ve. George Friedman, me rastin e vdekjes së Solzhenicin shkruante se Solzhenicin “e përçmonte obsesionin [e liberalëve] me të drejtat individuale, siç është e drejta për shprehje të lirë të pakufizuar ... [sipas tij] problemi themelor me të cilin përballej njerëzimi i kishte rrënjët në iluminizmin francez dhe shkencën moderne.” Në librin Rindërtimi i Ruisë, Solzhenicin do të shkruante për një Rusi të re që përfshin territorin e Republikës Sovjetike Ruse dhe të gjitha territoret e banuara nga rusët në të gjithë republikat e tjera Sovjetike.<sup>37</sup> “Në zemër të kësaj Rusie do të ishte Kisha Ortodokse Ruse, jo vetëm me spiritualitetin, por edhe me traditat, ritualet dhe artin e saj. Misioni i shtetit do të ishte mbrojtja e mëmëdheut, krijimi i kushteve për rilindje kulturore dhe - jo pa rëndësi - sigurimi i një jete ekonomike të denjë për qytetarët e tij. Rusia do të ngrihej mbi dy shtylla: shteti dhe kisha”,<sup>38</sup> një Republikë Ortodokse.

Ndoshta mënyra më e mirë për ta kuptuar ndikimin rus në Kosovë si pjesë të kësaj bote alternative ruse, është përmes shkrimeve të Aleksandër Dugin. Dugin, ky ideolog i afërt me elitat politike ruse, ndryshe nga Iljin ose Solzhenicin, ofron një kornizë për mënyrën e krijimit të një Rusie të re dhe të madhe. John B. Dunlop, në shqyrtimin e tij për traktatin politik të Dugin “Themelet e Gjeopolitikës” shkruan se “Dugin beson se atlanticistët (veçanërisht Shtetet e Bashkuara) komplotuan me vetëdije për rënien e Paktit të Varshavës dhe BRSS-së. Prandaj, Zemra [Rusia] duhet ta bëjë Fuqinë Detare [SHBA-të] të paguajë në të njëjtën monedhë.”<sup>39</sup> Qëllimi, siç e sheh Dugin, është ringjallja dhe rigjallërimi i Euroazisë/Ruisë pas goditjeve pothuajse fatale gjeopolitike që ajo pësoi nga viti 1989 deri në 1991” duke i sulmuar SHBA-të kudo që gjenden SHBA-të. Në Kosovë, Rusia mund ta prishë shtetndërtimin e udhëhequr nga SHBA-të pa bërë ndonjë investim të madh (ajo mbështetet në Serbinë dhe serbët lokalë që ia kryejnë punët në nivel lokal, dhe në diplomacinë e saj për ta kundërshtuar qasjen e Kosovës në institucionet ndërkombëtare dhe njohjen e saj), pa u brengosur për kundërgoditje serioze, pasi Kosova faktikisht nuk është anëtare e NATO-s, BE-së, apo e OKB-së.

Kosova përfaqëson simbolin më të dukshëm të politikës ndërhyrëse liberale të SHBA-ve dhe BE-së të viteve 90-të. Kosova është shteti i fundit që doli nga shpërbërja e dhunshme e Jugosllavisë, dhe çlirimi i saj nga okupimi serb erdhi si rezultat i ndërhyrjes së NATO-s, kurse shtetësia nga projekti i ndërtimit të kombit që ndërmori komuniteti ndërkombëtar gjatë protektoratit të OKB-së (1999-2007). Për politikëbërësit rusë, sukcesi i SHBA-ve dhe BE-së në Ballkan, përfshirë Kosovën, do të shkaktojë një efekt domino në rajon. Sipas Këshillit Rus (RIAC) “Tërheqja e Ruisë nga Ballkani do të thotë **humbje e pozitës në Evropën Juglindore**, çka do ta kufizojë hapësirën për veprim në Mesdhe. Kjo do të rezultojë në atë që Bashkimi Evropian dhe NATO-ja do të ushtrjnë presion

36 Barbashin, Anton, dhe Hannah Thoburn. 2015. “Filozofi i Putinit: Ivan Iljin dhe ideologjia e sundimit të Moskës.” *Foreign Affairs*, 2015. <https://www.foreignaffairs.com/articles/russian-federation/2015-09-20/putins-philosopher>.

37 Rowley, David G. 1997. “Aleksandër Solzhenicin dhe nacionalizmi rus.” *Gazeta e Historisë Bashkëkohore* 32 (3): 321–37. <http://www.jstor.org/stable/260964>.

38 Friedman, George. 2008. “Solzhenicin dhe lufta për shpirtin e Ruisë”. *Stratfor*. 5 gusht 2008. <https://worldview.stratfor.com/article/solzhenitsyn-and-struggle-russias-soul>.

39 Dunlop, John B. 2004. “Themelet e gjeopolitikës nga Aleksandër Dugin.” *Demokratizatsiya* 12 (1): 41–58. <https://tec.fsi.stanford.edu/docs/aleksandr-dugins-foundations-geopolitics>.



edhe më të madh **mbi shtetet transkaukaziane dhe Bjellorusinë**. Humbja e Ballkanit do ta ngushtojë hapësirën për manovër të Ruisë në marrëdhëniet e saj me **Turqinë**, një vend që po e forcon pozitën e vet në Evropën Juglindore. Pozicioni i Ruisë në bisedimet e saj me Kinën do të dobësohet; për **Kinën**, Ballkani është pika e fundit në Rrugën e Re të Mëndafshit.<sup>40</sup>

Për Ruisë, nëse SHBA-të dhe BE-ja nuk mund të kenë sukses në Kosovë (popullatë e vogël, homogjene, absolutisht pro-amerikane/evropiane), ato nuk mund të kenë sukses në eksportimin e ideve liberale perëndimore askund tjetër (shtete më të mëdha me popullatë më të madhe që nuk janë aq pro-amerikane). Ky dështim i mundshëm i SHBA-ve i ofron Ruisë një mundësi promovimi të planit të saj politik si një alternativë ndaj liberalizmit perëndimor në vende evropiane dhe më tej. Sipas RIAC, Rusia duhet të angazhohet taktikisht në: “[k]rijimin dhe mbështetjen e forcave politike konstruktive në Serbi, Slloveni, Kroaci, Shqipëri dhe vende të tjera në rajon, forca që do të ishin të orientuara drejt projekteve të Moskës.” Dhe, duke promovuar narrativat e reja mediatike për ‘Ruisë si një mjet i stabilitetit rajonal’, ‘Ruisë si një mjet i bashkëpunimit humanitar’ dhe ‘Ruisë si furnizuese e e-teknologjive dhe zgjidhjeve efikase teknologjike’.<sup>41</sup> Rusia ka pasur shkallë të ndryshme të suksesit në rajon. Me Serbinë (partneri i saj më i madh në rajon) ajo ka ndërtuar një marrëdhënie shumëdimensionale që përfshin politikën, ushtrinë, ekonominë dhe lidhjet mes njerëzve, ndërsa me vendet e tjera sllave në rajon Rusia ka ndërtuar marrëdhënie të forta dypalëshe të bazuara në shitjen e gazit natyror dhe investime të huaja direkte.

## Serbia, një trampolinë rajonale për politikën e jashtme ballkanike të Ruisë

Objektivi i dytë i madh gjeostrategjik i ndikimit rus në Kosovë është të fitojë kapital në Serbi. Një zyrtar perëndimor që këshillon qeverinë e Kosovës<sup>42</sup>, kur u pyet nëse Kosova ka rëndësi për Perëndimin, u përgjigj se një pikëpamje e përbashkët mes anëtarëve të BE-së është se Serbia përfaqëson shpërblimin më të madh në rajon. “Politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht” përfitimet nga Serbia kanë një rëndësi më të madhe sesa nga Kosova. Dhe, rusët duken se e kuptojnë më së miri rëndësinë e Serbisë në rajon, të paktën në perceptimet e politikëbërësve evropianë, si dhe domethënien e saj strategjike. Nëse Rusia nuk mund të ketë sukses në Serbi (një vend me të cilin ajo ndan lidhje etno-fetare, një popullatë me shumicë dërrmuese pro-ruse, lidhje të forta historike dhe ekonomike) është shumë e vështirë që Rusia të jetë më e suksesshme në fitimin e aleatëve jashtë “fqinjëve të saj të afërt”, pa përdorur ndërhyrjet ushtarake.

Kosova i shërben Ruisë për pazaret që bën me Serbinë për të marrë atë që do nga Serbia. Rusia ka nevojë për një bazë miqësore për veprime në Ballkan dhe asnjë vend nuk është më mirë i pozicionuar sesa Serbia për ta bërë këtë. Në këmbim, Serbia mbështetet në aftësitë diplomatike të Ruisë për të promovuar dhe mbrojtur pretendimet e saj mbi Kosovën.

Rusia jo gjithmonë i ka promovuar dhe/ose mbrojtur interesat ose pretendimet e Serbisë në Kroaci, Bosnjë ose Maqedoni të Veriut. Ajo njohu pavarësinë e Kroacisë dhe Maqedonisë së Veriut përpara se këtë ta bënin SHBA-të. Në rastin e Bosnjës, ajo iu bashkua anëtarëve të tjerë

40 Entina, Ekaterina, dhe Alexander Pivovarenko. pa datë. “Rusia në Ballkan”. Këshilli Rus i Çështjeve Ndërkombëtare. Qasur më 22 shtator 2020. <http://russiancouncil.ru/en/russia-balkans/>.

41 Po aty.

42 Anonim (këshilltar perëndimor i Qeverisë së Kosovës). Intervistë me Elis Vllasin. Prishtinë, 4 shkurt 2020.

të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për të vendosur një embargo naftë dhe sanksione të tjera ndaj Jugosllavisë (d.m.th. Serbisë dhe Malit të Zi) duke dënuar përfshirjen e Serbisë në luftën e Bosnjës. Sidoqoftë, Lufta e Kosovës ka shërbyer si pikë kthese për rusët. Më 24 mars 1999, NATO-ja ndërhyri ushtarakisht për t'i dhënë fund luftës në Kosovë, pasi ndërhyrja e sanksionuar nën Kapitullin 7 të OKB-së nuk ishte e mundur për shkak të kërcënimeve ruse me veto. Në prill 2007, Martti Ahtisaari (ish Presidenti i Finlandës) paraqiti në KS të OKB-së Planin e Ahtisaarit që detajonte rrugën e Kosovës drejt pavarësisë, por ai u refuzua nga Serbia me këmbënguljen e Rosisë.<sup>43</sup> Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt 2008, Rusia nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës dhe ka kërcënuar të vërë veton për çdo aplikim të Kosovës për anëtarësim në OKB. Është fuqia e vetos së Rosisë në KS të OKB-së që nuk i ka lejuar Kosovës konsolidimin e plotë të shtetësisë së saj.

Rusët janë të vendosur se çdo zgjidhje për çështjen e Kosovës, duhet të mbrojë pretendimet e Serbisë ndaj Kosovës dhe të aprovohet nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së ku Rusia ka veton. Në vizitën e tij në Serbi më 18 qershor 2020, Ministri i Jashtëm Lavrov deklaroi,

**“Qëndrimi i Rosisë për zgjidhjen e Kosovës mbetet i pandryshuar. Sot e konfirmuam edhe një herë. Ne do të mbështesim çdo përpjekje, hap ose iniciativë që mundet realisht të ndihmojë Beogradin dhe Prishtinën të arrijnë një vendim të zbatueshëm dhe reciprokisht të pranueshëm bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së... Së pari dhe më e rëndësishmja, vendimi që të gjithë duam të arrijmë duhet të jetë në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe, natyrisht, të miratohet nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së”.**<sup>44</sup>

Për këtë qëllim, përpjekja e Serbisë për të delegjitimuar pavarësinë e Kosovës, duke bërë që disa vende të “tërheqin njohjet e tyre” të Kosovës, i është atribuuar kryesisht përpjekjeve diplomatike ruse.<sup>45</sup> Më tej, mediat globale ruse, siç janë Russia Today (RT) dhe Sputnik News, janë angazhuar në një fushatë dezinformuese kundër Kosovës, duke synuar “të krijojnë një perceptim të përhershëm negativ për Kosovën”<sup>46</sup> nëpër botë. Projekti “BE-ja kundër Dezinformimit” i Task Forcës East StratCom, i Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm, tregon 45 raste të “lajmeve” dezinformuese të shtyra nga media ruse (në gjermanisht, spanjisht, anglisht, frëngjisht, italisht, rusisht) që e portretizojnë Kosovën si një shtet të lidhur me terrorizmin, shtet të korruptuar, që shtyn një pakt anti-serb, ekzistenca e të cilit është e paligjshme, etj.<sup>47</sup>

Në këmbim të ndihmës së tyre për Kosovën, rusët kanë ndjekur një strategji të dyfishtë me Serbinë. Nga njëra anë, Rusia ka bërë përpjekje serioze për kontrollimin e industrive strategjike të Serbisë. Në vitin 2008, Serbia ia shiti Gazprom Neft-it për 400 milionë euro

43 Radeljic, Branislav. 2017. “Përfshirja e Rosisë në rastin e Kosovës: Mbrojtja e interesave serbe apo sigurimi i ndikimit të saj në Evropë?” Rajoni: Studime Rajonale të Rosisë, Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore 6 (2): 273–300.

44 Lavrov, Sergei. 2020. “Deklarata e Ministrit të Jashtëm Sergei Lavrov dhe përgjigjet në pyetje të mediave në një konferencë të përbashkët për shtyp pas bisedimeve me Presidentin e Republikës së Serbisë Aleksandër Vuçiq, Beograd, 18 qershor 2020.” Ministria e Punëve të Jashtme e Federatës Ruse. Shkarkuar më 22 shtator, 2020 ([https://www.mid.ru/press\\_service/minister\\_speeches/-/asset\\_publisher/7OvQR5KJWVmR/content/id/4168763](https://www.mid.ru/press_service/minister_speeches/-/asset_publisher/7OvQR5KJWVmR/content/id/4168763)).

45 Radio Evropa e Lirë mbi “lidhjen ruse” në tërheqjen e njohjeve të Kosovës. (25 korrik 2019). B92.Net. [https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2019&mm=07&dd=25&nav\\_id=107056](https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2019&mm=07&dd=25&nav_id=107056)

46 Enver Hoxhaj. Intervistë me Elis Vllasin. Intervistë personale. Prishtinë, 22 janar 2020.

47 “Rastet e dezinformimit”. 2020. BE-ja kundër DEZINFORMIMIT. 2 prill 2020. <https://euvsdisinfo.eu/disinformation-cases/>.

pjesën më të madhe të aksioneve të saj në NIS (Industria e Naftës e Serbisë), nën çmimin real të kompanisë prej 2 miliardë eurosh.<sup>48</sup> Sipas CSD, “Rusia është ngulitur fort në sektorin serb të naftës dhe gazit. Serbia importon nga Rusia afërsisht 65 për qind të nevojave të saj për gaz natyror dhe më shumë se 70 për qind të konsumit të saj të naftës bruto.”<sup>49</sup>

Nga ana tjetër, në çështjet e politikës së jashtme Serbia e ka harmonizuar politikën e saj të jashtme me Rusinë për çështje me interes për Rusinë. Serbia, përkundër statusit të saj si vend kandidat për në BE, ka refuzuar t’i harmonizojë politikat e saj me ato të BE-së për çështjet që lidhen me Rusinë. Në vitin 2014, Serbia ishte i vetmi vend në Evropë që nuk vendosi sanksione ndaj Ruisë për aneksimin e Krimesë prej saj. Ajo ka vazhduar të votojë kundër çdo rezolute në OKB që është kritike ndaj Ruisë.<sup>50</sup> Në vitin 2019, Serbia nënshkroi një marrëveshje të tregtisë së lirë me Bashkimin Ekonomik Euroaziatik të udhëhequr nga Rusia, pavarësisht paralajmërimeve nga BE-ja se një marrëveshje e tillë bie ndesh me procesin e kandidimit të Serbisë për anëtarësim në BE. Për fundi, prej vitit 2012 Serbia ka mbajtur Qendrën Humanitare Ruse Serbe (RSHC) në Nish. Sipas ueb faqes zyrtare, “RSHC është një organizatë ndërqeveritare humanitare jofitimprurëse me të drejtat e një personi juridik”<sup>51</sup> detyrat e të cilës përfshijnë sigurimin e ndihmës humanitare në raste emergjente, si dhe trajnimin dhe zhvillimin profesional të personave që përgjigjen në raste emergjente, ndër detyrat e tjera. Sidoqoftë, bazuar në pretendimet e nënkolonelit Imer Avdiu (Forca e Sigurisë së Kosovës) dhe nga burime ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë<sup>52</sup>, RSHC-ja nuk është asgjë tjetër veçse një mbulesë për një instalim të inteligjencës ruse në rajon dhe një bazë operacionesh. Siç nënvizon nënkoloneli Avdiu, lokacioni i RSHC-së i siguron Ruisë një prani brenda 160 kilometrave nga baza ushtarake “Bondsteel” e SHBA-ve, trupat e BE-së në Bosnjë, dhe është pranë anëtarëve të NATO-s, Shqipërisë, Bullgarisë, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, dhe Rumanisë.

## Taktikat ruse në operacionet e ndikimit

Taktikat e Moskës për ndjekjen e këtyre objektivave strategjike përfshijnë:

- 1) Përça dhe sundo,
- 2) Kapjen e elitës,
- 3) Shfrytëzimin e pritjeve joreale,
- 4) Imazhin pozitiv që gëzon Rusia në mesin e popullatës lokale.<sup>53</sup>

Fox dhe Clarkhall<sup>54</sup> janë më specifike për sa i përket instrumenteve në të cilat mbështetet Rusia për ta zgjeruar ndikimin e saj:

48 Cassata, Peter. 2008. “Politika e Gazsjellësit: Gazprom nënshkruan marrëveshjen me Serbinë.” Atlantic Council (blog).

29 dhjetor 2008. <https://www.atlanticcouncil.org/blogs/new-atlanticist/pipeline-politics-gazprom-seals-serbia-deal/>.

49 CSD. 2018. “Gjurma ekonomike ruse në Ballkanin Perëndimor. Risqet e korrupsionit dhe kapjes së shtetit.” Sofje: Qendra për Studimin e Demokracisë. <http://old.csd.bg/artShow.php?id=18228>.

50 Zivanovic, Maja. 2019. “Serbia mbështet Rusinë kundër rezolutës së OKB-së mbi Krimeën.” Balkan Insight. 10 dhjetor 2019. <https://balkaninsight.com/2019/12/10/serbia-backs-russia-over-un-resolution-on-crimea/>.

51 “Rreth Nesh | Qendra Humanitare Ruse-Serbe”, pa datë Qasur më 27 shtator 2020. <http://en.ihc.rs/about>.

52 Avdiu, Imer. Intervistë me Elis Vllasin. Prishtinë, 21 janar 2020.

53 Galeotti, A përballet Ballkani Perëndimor me një stuhi ruse në ardhje?; Bechev, Dimitar. 2018. “Të kuptuarit e ndikimit të Ruisë në Ballkanin Perëndimor”. Shtator 2018 Analizë Strategjike. Qendra Evropiane e Ekselencës për Luftimin e Kërcënimeve Hibride. <https://www.hybridcoe.fi/wp-content/uploads/2018/10/Strategic-Analysis-2018-9-Beshev-.pdf>.

54 Clark, David, dhe Andrew Foxall. 2014. “Roli i Ruisë në Ballkan - shkak për shqetësim”. Shoqëria Henry Jackson. Qershor 2014 <https://henryjacksonsociety.org/wp-content/uploads/2014/06/Russias-Role-in-the-Balkans.pdf>.



Menjya e taktikave të disponueshme për operacionet e ndikimit është e gjatë dhe eklektike, por përdorimi i tyre varet gjithnjë e më pak nga zgjedhja e një taktike kundrejt një tjetre, por nga “një kombinim i ofensivave për ndërhyrje në punët e fqinjëve, kapja e sektorëve të rëndësishëm të ekonomive lokale, minimi i sistemeve të cenushme politike, korruptimi i udhëheqësve kombëtarë, depërtimi në institucionet kyçe të sigurisë, prishja e unitetit kombëtar dhe territorial, kryerja e ofensivave propagandistike përmes një spektri mediash dhe rrjetesh sociale, dhe vendosja e një morie mjetesh të tjera për t’i dobësuar qeveritë kokëforta që i rezistojnë Moskës” (Bugajski 2016: 6).

Një nga rastet e para të operacioneve të suksesshme të ndikimit rus në lidhje me Kosovën përfshiu operacionet e saj të mashtrimit kundër anëtarëve të NATO-s për të siguruar që forcat ruse do të ishin të parat që hynë në Kosovë me nënshkrimin e Marrëveshjes Teknike Ushtarake (e njohur edhe si Marrëveshja e Kumanovës) më 9 qershor 1999. Për të mos lejuar që forcat e NATO-s të ishin forcat e para ndërkombëtare që do të hynin në Kosovë, një kontigjent ushtarak rus që ishte vendosur në Bosnjë si pjesë e SFOR-it, braktisi detyrat që kishte dhe filloi dislokimin në Kosovë. Teksa CNN dhe media të tjera ndërkombëtare shfaqnin automjetet e blinduara ruse që po i afroreshin kufirit të Kosovës, më 11 qershor 1999, ministri i jashtëm rus Igor Ivanov “e siguroi Albright se rusët po zinin pozicione jashtë kufijve të Kosovës, në përgatitje për të hyrë në provincë

kur të arrihej një marrëveshje.”<sup>55</sup> Kur trupat ruse vazhduan rrugën drejt Prishtinës, ata u pritën me brohoritje nga serbët vendas. “[p]ak pasi trupat ruse mbërritën në Prishtinë... Ivanov tha për CNN se ishte për të ardhur keq që ata kishin hyrë në Kosovë dhe se iu ishte dhënë urdhri të tërhiqeshin menjëherë. Trupat u vendosën pranë aeroportit të Prishtinës dhe nuk dhanë asnjë shenjë se do të largoheshin menjëherë. Diplomati të tjerë e justifikuan lëvizjet ruse si “vepër e një komandanti të rebeluar rus”.<sup>56</sup> Përkundër dështimit të masterplanit rus për të fituar një bazë në Aeroportin e Prishtinës dhe më pas për të transportuar nga ajri mijëra ushtarë rusë në mënyrë që të kapnin hapësirën e tyre të ndikimit në zonat me shumicë serbe, rusët ia dolën me sukses që ta detyronin NATO-n t’i përfshinte rusët si pjesë e KFOR-it.

U bë kohë që ushtarët rusë pjesë e KFOR-it janë larguar nga Kosova, por operacionet e ndikimit rus nuk kanë të reshtur. Gjatë viteve rusët janë akuzuar, dhe nganjëherë janë kapur për përfshirje në operacione ndikimi. Çështja e zyrtarit të UNMIK-ut të kapur duke u ndihmuar protestuesve serbë në Zubin Potok për të parandaluar policinë e Kosovës nga ushtrimi i detyrës së vet ka fituar vëmendje më të madhe për shkak të arrestimit dhe dëbimit të tij,<sup>57</sup> por ka pasur shembuj të tjerë më pak të njohur. Në vitin 2014, Vitali Molonov, “Luftëtar i Kulturës Ortodokse Ruse”, ligjvënësi fuqimisht anti-homoseksual, hapi “një qendër ruse për të drejtat e njeriut” (OJQ) në Mitrovicë pa e regjistruar fare pranë autoriteteve kosovare.<sup>58</sup> Më 9 janar 2020, agjentët rusë u panë duke marrë pjesë në një protestë serbe në Graçanicë,<sup>59</sup> dhe disa ditë më vonë, Andrei Kondrashov, gazetari rus dhe “propagandist i afërt me Putinin”,<sup>60</sup> u ndalua dhe u intervistua nën dyshimin se “është maskuar si gazetar me qëllim të mbledhjes së informacionit të ndjeshëm, i cili mund të dëmtojë sigurinë e Republikës së Kosovës”.<sup>61</sup>

55 Hoffman, David. 1999. “Bisedimet e dështuara të NATO-s shkaktuan vrapimin e Ruisë drejt Kosovës.” Washington Post, 12 qershor 1999. <https://www.washingtonpost.com/archive/politics/1999/06/12/failed-nato-talks-triggered-russias-run-to-kosovo/2e88444c-de8a-457f-899c-c8c5a9f9ea1f/>

56 Lally, Kathy, dhe Mark Matthews. 1999. “Inkursioni në Kosovës habit aleatët; shfaqja e forcës mes motiveve të mundshme.” Baltimore Sun, 12 qershor 1999. <https://www.baltimoresun.com/news/bs-xpm-1999-06-12-9906120123-story.html>.

57 Begisholli, Blerta. 2019. “Anëtar i arrestuar rus i stafit të UNMIK-ut lëshon Kosovën për në Serbi.” Balkan Insight. Shkarkuar më 25 shtator 2020 (<https://balkaninsight.com/2019/05/30/arrested-russian-unmik-staffer-leaves-kosovo-for-serbia/>).

58 Scekcic, Jasmina. 2014. “Luftëtar i Kulturës Ortodokse Ruse vjen në ndihmë të serbëve të Kosovës.” Radio Free Europe/Radio Liberty. 2 shkurt 2014. <https://www.rferl.org/a/kosovo-serbs-russian-orthodox-warrior/25250663.html>.

59 Gazeta Express. 2020. “Agjentët e Inteligjencës Ruse Po Qëndrojnë Në Kosovë, Planifikojnë Trazira Në Prizren.” Gazeta Express. 13 janar 2020. <https://www.gazetaexpress.com/agentet-e-intelegjences-ruse-po-qendrojne-ne-kosove-planifiko-jne-trazira-ne-prizren/>.

60 “Lista e Putinit”. Baza e të dhënave e Forumit Rusia e Lirë, 2020. <https://www.spisok-putina.org/en/personas/kondrashov-2/>.

61 Pajaziti, M. “Kosova e frikësuar nga ndikimi rus”. Agjencia e Pavarur e Lajmeve Ballkanike, 14 janar 2020. <https://balkanneu.com/kosovo-fearful-of-russian-influence/>.

# AKTORË TË MUNDSHËM NË SAGËN RUSE

Cilët janë aktorët kryesorë përmes të cilëve Rusia ushtron ndikimin e saj në Kosovë? Tre aktorë mund të shërbejnë potencialisht, në shkallë të ndryshme dhe me ose pa vetëdije, si transmetues ose agjentë të ndikimit.

## Kosovarët dhe shqiptarët <sup>62</sup>

Aktorët më pak të mundshëm dhe të gatshëm për ndikim janë kosovarët, të cilët janë ndoshta populli më anti-rus në gadishullin Ballkanik. Një anketë e Barometrit të Sigurisë për vitin 2017, e realizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), konstatoi se 53.2% e të anketuarve e konsideronin Rusinë si “shumë armiqësore” dhe 29% të tjerë si “armiqësore”, ndërsa 75% e të anketuarve mendonin se ndikimi i Rusisë ishte “i dëmshëm”. <sup>63</sup> Ndryshe nga kombet e tjera në Ballkan që kanë lidhje me rusët ose përmes fiseve sllave (sllavët e jugut përfshirë bullgarët) ose besimit të krishterë ortodoks (grekë, rumunë), kosovarët nuk kanë lidhje me rusët as përmes fiseve as përmes fesë.

Në vendet ku mungojnë lidhjet etno-fetare, Rusia është mbështetur në instrumentet ekonomike për ta detyruar dhe futur në kallëp popullatën/qeverinë lokale. Në EQL, arma më e fuqishme e Rusisë në operacionet e saj të ndikimit ka qenë gazi natyror dhe IHD-të. “Furnizimet e tubacioneve ruse mbetën burimi kryesor i importeve të gazit në BE” <sup>64</sup> dhe kjo varësi po rritet teksa importet neto u rritën me 21% në tremujorin e dytë të vitit 2019, krahasuar me të njëjtën periudhë në 2018. <sup>65</sup> Kjo varësi nga gazi natyror rus ndryshon sipas vendit. Vendet e BE-së në rajon (Greqia, Bullgaria, Rumania dhe Kroacia) janë të varura në një shkallë të madhe nga gazi rus. Vende si Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Bosnja marrin mes 75-100% të gazit të tyre natyror nga Rusia. <sup>66</sup>

Në Kosovë, përveç përballjes me një popullatë armiqësore, Rusia nuk është në gjendje t’i shfrytëzojë lidhjet ekonomike, pasi nuk ka të tilla. Ekonomia e Kosovës nuk varet nga gazi natyror. Gazprom nuk ka asnjë shitje të gazit natyror për vitin 2018 në Kosovë dhe Shqipëri. <sup>67</sup> Për më

62 Në këtë raport, unë e përdor termin “kosovar” për t’iu referuar shqiptarëve të Kosovës. Shumica e popullatës së Kosovës janë shqiptarë etnikë. Për t’i diferencuar shqiptarët e Kosovës nga të Shqipërisë, shpesh këta quhen “shqiptarë të Kosovës”.

63 Emini, Donika. 2016. “Perceptimi publik për politikën e jashtme dhe dialogun me Serbinë”. “Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i Posaçëm.” Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. <http://www.qkss.org/en/Reports/Public-Perceptions-towards-Foreign-Policy-and-Dialogue-with-Serbia-633>.

64 Drejtoria e Përgjithshme e Energjisë. 2019. “Raportet e Tregut të Gazit dhe Energjisë Elektrike”. Analiza e tregut. Komisioni Evropian [https://ec.europa.eu/energy/data-analysis/market-analysis\\_en](https://ec.europa.eu/energy/data-analysis/market-analysis_en).

65 Po aty.

66 Shiryaevskaya, Anna, dhe Dinna Khrennikova. 2019. “Pse bota shqetësohet për tubacionin e gazit natyror të Rusisë”. Washington Post. 6 nëntor 2019. [https://www.washingtonpost.com/business/energy/why-the-world-worries-about-russias-natural-gas-pipeline/2019/10/31/c3c12892-fbfb-11e9-9e02-1d45cb3dfa8f\\_story.html](https://www.washingtonpost.com/business/energy/why-the-world-worries-about-russias-natural-gas-pipeline/2019/10/31/c3c12892-fbfb-11e9-9e02-1d45cb3dfa8f_story.html).

67 “Statistikat e furnizimit”. Eksportet e Gazprom, 2018. <http://www.gazpromexport.ru/en/statistics/>.

tepër, niveli i IHD-ve ruse është i papërfillshëm. Sipas statistikave të Kosovës për vitin 2016, investimet e Ruisë kapin 2 milionë dollarë, kurse eksportet 7 milionë dollarë. Sipas Vicek dhe Jirusek, kompanitë ruse të naftës kanë një prani në pjesët me shumicë serbe të Kosovës, përmes filialeve të tyre serbe (Beopetrol-Pristina Doo).<sup>68</sup> Sidoqoftë, të dhënat më të fundit tregojnë se kjo kompani është në likuidim (falimentim), dhe vetëm një kompani, Lukoil Lubricants, ka Inter Trading si agjentin e vet në Kosovë.<sup>69</sup>

Atëherë, si mundet një popullatë fuqimisht anti-ruse të bëhet aktor i ndikimit rus në Kosovë? Padashur, natyrisht! Këshilltari perëndimor i qeverisë së Kosovës deklaroi se “kosovarët janë bërë transmetues të ndikimit rus dhe ata madje as nuk e dinë këtë... duke dobësuar përpjekjen për shtetndërtim përmes avancimi të interesave personale”. Valon Kurhasani i Institutit Demokratik Kombëtar-Kosovë dhe Enver Hoxhaj janë dakord se kosovarët janë pa dashje bashkëpunëtorë, pasi mediat lokale shpesh bartin lajme të paketuara ruse pa verifikuar burimin e informacionit. Shpesh, lajmet ruse të mbjella në mediat “perëndimore” thjesht përkthehen në shqip. Disa herë, mediat lokale bartin histori të fuqisë ruse, sërish pa e shqyrtuar burimin e informacionit.

Pavarësisht nga mungesa e dashurisë për rusët ose Rusinë mes shqiptarëve, ekzistojnë disa shqetësime të paktën tek një zyrtar qeveritar dhe një oficer i lartë i KFOR-it, se ndikimi rus mund të depërtojë përmes Shqipërisë. Një zhvillim që e befasoqi qeverinë e Kosovës ishte “vizita historike” e Patriarkut Rus Kiril në Shqipëri më 28 prill 2018. Patriarku rus u mirëprit nga kreu i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Kryepeshkopi Anastas,<sup>70</sup> dhe më pas zhvilloi nga një takim të veçantë me Kryeministrin Edi Rama dhe Presidentin Ilir Meta. Homologëve kosovarë nuk iu dha asnjë shpjegim në lidhje me qëllimin e vizitës së Patriarkut në Shqipëri.

Kohët e fundit, ka pasur disa spekulime se oligarkët rusë po afrohen me politikanët shqiptarë. Sipas Mursa Musabelliu, Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror të Shqipërisë u paraqit para komisionit parlamentar të sigurisë në një seancë të mbyllur dëgjimore dhe dëshmoi në lidhje me përpjekjet e Ruisë për të zgjeruar ndikimin e saj në vend. Është raportuar se në 2005 dhe 2007, operativët rusë u përpoqën të krijonin lidhje në Ushtrinë Shqiptare dhe tentuan “të ndikonin në punët e brendshme me veprime që shtriheshin nga mbledhja e informacionit deri te pjesëmarrja aktive në rekrutimin e shtetasve shqiptarë” që ishin pjesë e aparatit burokratik në vend.<sup>71</sup>

Për më tepër, si reagim ndaj një raporti të Mother Jones, në vitin 2019 prokurorët në Shqipëri ngritën akuza kundër Lulzim Bashës, kreu i Partisë Demokratike të Shqipërisë, në lidhje me më shumë se 600,000 dollarë në pagesa që partia e tij raportohet të ketë bërë në vitin 2017 për një lobist republikan për të rregulluar një takim mes z. Basha dhe Presidentit Donald Trump. Akuzat ishin se “kompania guacë me bazë në Skoci e lidhur me shtetas misteriozë rusë... mund të ketë ndihmuar në mbështetjen e lobimit të Bashës në Shtetet e Bashkuara, duke qenë se ai ka avokuar për politika relativisht nacionaliste më të përshtatshme për preferencat e Ruisë për Ballkanin.”<sup>72</sup>

68 Vlček, Tomáš, dhe Martin Jirušek. 2019. Ndërmarrjet ruse të naftës në Evropë. Botimet Ndërkombëtare Springer.

69 “Agjentët”. Lukoil, 2020. <https://lukoil-lubricants.ro/en/Distribution/Dealers>.

70 Shërbimi i Komunikimit DECR. 2018. “Patriarku Kiril takohet me Presidentin e Shqipërisë”. Kisha Ortodokse Ruse. 30 prill 2018. <http://www.patriarchia.ru/en/db/text/5188771.html>

71 Musabelliu, Marcela. 2019. “Informim për Marrëdhëniet e Jashtme të Shqipërisë: Biseda e Kombit: Ndikimet e mundshme të Ruisë në Shqipëri.” Instituti Kinë-EQL. 2 maj 2019. <https://china-cee.eu/2019/05/02/albania-external-relations-briefing-the-talk-of-the-nation-russias-potential-influences-in-albania/>.

72 Levintova, Hannah, dhe Dan Friedman. 2019. “Kreu i Partisë Konservatore të Shqipërisë përballet me akuza penale dhe përfshihet një ish ndihmës i Trumpit.” Mother Jones. 13 qershor 2019 <https://www.motherjones.com/politics/2019/06/the-head-of-albanias-conservative-party-faces-criminal-charges-and-an-ex-trump-aide-is-involved/>.

Sipas dokumenteve të Departamentit të Drejtësisë të SHBA-ve, Biniatt Trade i pagoi Muzin Capitol Partners LLC 600,000 dollarë për të nxjerrë në pah kontributet e diasporës shqiptare në SHBA dhe shoqërinë perëndimore.<sup>73</sup> Ueb faqja e Shtëpisë së Kompanive të Mbretërisë së Bashkuar tregon një farë Konstantin Ferulev (shtetas rus) si “person me kontroll të rëndësishëm” në KF Global Management LLP, një filial i Asverro Corporation, një partner i Biniatta Trade.<sup>74</sup> Sidoqoftë, në vitin 2020, Gjykata e Rrethit Tiranë i rrëzoi të gjitha akuzat kundër Lulzim Bashës.<sup>75</sup>

Teksa nuk arritën të kishin një ndikim të rëndësishëm me rekrutimin, rusët kanë kapitalizuar platformën politike të “Shqipërisë së Madhe”<sup>76</sup> që ka një farë mbështetje mes shqiptarëve në të gjithë rajonin. Ekziston një numër i konsiderueshëm i kosovarëve që kërkojnë bashkimin me Shqipërinë dhe historikisht kanë luajtur një rol të varur nga “vëllezërit” nga Shqipëria. Një anketë e vitit 2019 e kryer nga Fondacioni i Kosovës për Shoqërinë e Hapur dhe Fondacioni i Shoqërisë së Hapur në Shqipëri raporton se “po t’u jepej mundësia e zgjedhjes në një referendum, 75% e shqiptarëve në Shqipëri dhe 64% e shqiptarëve në Kosovë do të mbështesnin bashkimin kombëtar”.<sup>77</sup> Një mbështetje e tillë e përhapur për bashkimin u ka shërbyer mjaft interesave ruse në promovimin e platformës së pretenduar të Shqipërisë së Madhe për të lobuar kundër Kosovës. Rusia në mënyrë të rreme “akuzon shqiptarët e Kosovës për një sërë të këqijash, siç janë aspirata për të formuar një bashkim me Shqipërinë dhe krijimin e të ashtuquajturës Shqipëri e Madhe, kërcënimin e shteteve fqinje me plane për të krijuar një ushtri të Kosovës dhe kthimin e vendit në një bazë për terrorizëm ndërkombëtar”.<sup>78</sup> Kur Kosova tentonte të vendoste marrëdhënie diplomatike me vendet në Afrikë dhe Amerikën Latine, diplomatët e Kosovës shpesh pyeteshin për qëllimet e Kosovës në lidhje me “Shqipërinë e Madhe”.<sup>79</sup>

## Serbët e Kosovës dhe Serbia

Për të mos mbetur prapa në garën e dashurisë ndaj një fuqie tjetër të madhe, favorizimi serb i Rusisë është i ngjashëm me atë të kosovarëve për SHBA-të. Një anketë e vitit 2018 e NDI-së për Ballkanin Perëndimor, zbuloi se 60% e serbëve e shikonin Rusinë në terma më dashamirëse se

73 “Dëshmia B në Deklaratën e Regjistrimit në përputhje me Aktin e Regjistrimit të Agjentëve të Huaj të vitit 1938, të ndryshuar”. 2017. Departamenti i Drejtësisë i SHBA-ve. <https://efile.fara.gov/docs/6414-Exhibit-AB-20171114-2.pdf>.

74 <https://beta.companieshouse.gov.uk/company/OC391311/persons-with-significant-control>; Shikoni gjithashtu “AGRO-TEX NEMO TRADING INTERNATIONAL LP - Historia e Arkivimit”, pa datë Shtëpia e Kompanive. Qasur më 25 shtator 2020. <https://beta.companieshouse.gov.uk/company/SL022707/filing-history>.

75 “Gjykata shfajëson Kryetarin e PD-së Basha për mosraportimin e pasqyrave financiare të partisë.” 2020. Exit News. 13 janar 2020. <https://exit.al/en/2020/01/13/court-clears-pd-leader-basha-of-failing-to-report-party-financial-statements/>.

76 Termi “Shqipëri e Madhe” ka disa derivate, dhe të gjitha nënkuptojnë bashkimin e të gjithë shqiptarëve të mbetur në të gjithë ish Jugosllavinë dhe Greqinë me Shqipërinë. Kosovarët dhe shqiptarët përdorin termin “Bashkim Kombëtar” për t’iu referuar bashkimit paqësor të Kosovës me Shqipërinë. Sidoqoftë, Serbia dhe Rusia (kryesisht) por edhe grekët dhe maqedonasit kanë përdorur termat “Shqipëria e Madhe” dhe “Platforma e Tiranës” si një taktikë frikësuese për t’i portretizuar të gjithë shqiptarët si një hegjemon rajonal që do të përdorë forcën e armatosur për të sjellë bashkimin e të gjitha tokave shqiptare (Kosova, Shqipëria dhe pjesë të Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë).

77 Demi, Agron, dhe Blendi Çeka. 2019. “KOSOVË - SHQIPËRI Ndërveprimi, Dituria, Vlerat, Besimet, Bashkëpunimi dhe Bashkimi.” Prishtinë, Tiranë: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur / Fondacioni i Shoqërisë së Hapur në Shqipëri. [https://www.osfa.al/sites/default/files/raporti\\_plote\\_kosove\\_-\\_shqiperi\\_-\\_eng.pdf](https://www.osfa.al/sites/default/files/raporti_plote_kosove_-_shqiperi_-_eng.pdf).

78 RIA Novosti. 2019. “Ushtria e Kosovës mund të provokojë një krizë të re në Ballkan, sipas Ministrisë së Jashtme,” 15 prill 2019. <https://ria.ru/20190415/1552697746.html>.

79 Hoxhaj, Intervistë.



shtetet e tjera<sup>80</sup>, dhe 55% e tyre besonin se Rusia është ushtarakisht superiore se NATO-ja.<sup>81</sup> Në një vizitë të vitit 2019 në Beograd, Presidenti Putin u prit me “kremtime të bujshme”,<sup>82</sup> derisa nga 56% e serbëve ai konsiderohet si udhëheqësi botëror më i besueshëm në botë.<sup>83</sup>

Dashuria e verbër për Rusinë është aq e fortë saqë 25% e popullatës beson se Rusia është donatori më i madh i Serbisë,<sup>84</sup> megjithëse BE-ja është “dukshëm investitori më i madh, partneri më i madh tregtar dhe donatori më i madh i Serbisë”.<sup>85</sup> Sipas të dhënave të BE-së, “[n]ë 10 vitet e fundit Investimet e Huaja Direkte kumulative të BE-së në Serbi kapën 15.4 miliardë euro... [me] 3 miliardë grante të pakthyeshme mes viteve 2001 dhe 2015, [dhe] 300 milionë euro donacione vjetore, [duke e vendosur Serbinë] në 3 vendet e para që marrin më shumë ndihmë financiare nga BE-ja.”<sup>86</sup> Pikëpamje të tilla të shtrembëruara të statusit prej donatori të Ruisë e befaskan Ministrin e Jashtëm gjerman Sigmar Gabriel gjatë vizitës së tij në Serbi në vitin 2017. Ai çuditej “pse njerëzit, gjatë rrugës nga aeroporti për në qendër të Beogradit, priten me një pano të madhe kushtuar miqësisë ruso-serbe, ndërsa ngjyrat e verdha dhe blu të Bashkimit Evropian janë plotësisht të padukshme.”<sup>87</sup>

Ka edhe anëtarë të elitës lokale serbe që ankohen se serbët e Kosovës janë gjithmonë “objekte dhe jo subjekte” në të gjitha çështjet që i përfshijnë ata. Disa anëtarë të shoqërisë civile serbe<sup>88</sup> pohojnë se serbët e Kosovës nuk janë aktorë autonomë që ekzekutojnë skemat e ndikimit të Ruisë në Kosovë. Burime të tjera, përfshirë burime ndërkombëtare, vërejnë se serbët lokalë janë “një krah i zgjatur i Ruisë”, por vetëm në shkallën që Serbia e lejon bashkëpunimin e tyre me rusët. “Kur bëhet fjalë për serbët e Kosovës, rusët duhet të kalojnë përmes Beogradit”, dhe megjithëse popullata mund të jetë dashamirëse ndaj Ruisë, serbët lokalë nuk janë në gjendje të bashkëpunojnë me Rusinë në kundërshtim me dëshirat e Serbisë, pasi popullata do të humbte të gjitha përfitimet që ua siguron Serbia.

Dy grupet e veçanta brenda komunitetit serb të Kosovës që janë implikuar në ndikimin rus përfshijnë udhëheqës politikë dhe grupe të organizuara kriminale, veçanërisht ato nga komunat veriore. Teksa Lista Serbe ka një marrëdhënie pune me partinë politike Rusia e Bashkuar,<sup>89</sup>

80 Shtete/institucione të tjera të përfshira në studim: Kina, BE-ja, Emiratet e Bashkuara Arabe, Turqia, SHBA-të, NATO-ja.

81 NDI. 2019. “Mes Lindjes dhe Perëndimit: Opinioni publik dhe dezinformimi i mediave në Ballkanin Perëndimor.” Instituti Demokratik Kombëtar. 25 janar 2019. <https://www.ndi.org/publications/between-east-and-west-public-opinion-media-disinformation-western-balkans>.

82 Hajdari, Una, dhe Michael Colborne. 2019. “Ka një vend në Evropë ku Putini është një yll”. Foreign Policy, 25 janar 2019. <https://foreignpolicy.com/2019/01/25/theres-one-country-in-europe-where-putin-is-a-rock-star-russia-serbia-vucic-belgrade-kosovo/>

83 Republika. 2019. “Kujt i besojnë serbët?! Ky është lideri botëror tek i cili kanë besim të plotë.” Republika. 1 mars 2019. <https://www.republika.rs/vesti/srbija/109216/kome-srbi-veruju-ovo-svetski-lider-koga-imamo-puno-poverenje>.

84 “Ndihej BE-ja, qytetarët mendojnë Rusia.” 2017. Radio Evropa e Lirë (RFE/RL). 5 qershor 2017. <https://www.slobodnaevropa.org/a/srbija-rusija-eu/28529994.html>.

85 “Partneriteti i BE-së me Serbinë: Partneri më i mirë i BE-së dhe donatori më i madh për 20 vjet - dhe në vijën e frontit kundër COVID-19.” 2020. Delegacioni i Bashkimit Evropian në Republikën e Serbisë. 24 prill 2020. <http://europa.rs/eu-partnership-with-serbia-eu-best-partner-and-biggest-donor-for-20-years-and-in-the-front-line-against-covid-19/?lang=en>.

86 Po aty.

87 Radio Evropa e Lirë, Ndihej BE-ja, qytetarët mendojnë Rusia.

88 Anonim (anëtar i një organizate serbe të Shoqërisë Civile). Intervistë me Elis Vllasin. Prishtinë, 4 shkurt 2020 dhe 6 shkurt 2020.

89 Vetëm Rusia e mbështeti Listën Serbe (2017) Lista Serbe. I disponueshëm në: <http://srpskalista.net/jedinstvena-rusija-podrzala-srpsku-listu/> (Qasur më: 25 shtator 2020).

sipas Enver Hoxhajt ka disa udhëheqës politikë<sup>90</sup> në mesin e komunitetit serb të Kosovës, por jo të gjithë, që janë fort pro-rusë në të njëjtën mënyrë me Ministrin e Jashtëm serb Ivica Daçiç dhe Ministrin e Mbrojtjes Aleksandër Vulin, dhe nuk hezitojnë që në Kosovë të bëjnë atë që do Rusia.<sup>91</sup> Disa aktorë të shoqërisë civile në Kosovë kanë deklaruar se atasheu rus në Prishtinë, Kira Kornilova,<sup>92</sup> merr pjesë pothuajse në çdo takim që përfshin serbët lokalë dhe se ndikimi i saj tek serbët është i rëndësishëm.<sup>93</sup> Për më tepër, rrjetet kriminale të organizuara serbe që veprojnë në komunat veriore janë përdorur për një kohë të gjatë si instrumente politike nga Serbia. Një oficer i inteligjencës i KFOR-it pohon se “grupet e krimit të organizuar (serb) ndjekin një agjendë që ka të ngjarë të ndikohet nga rusët”.<sup>94</sup>

## Kisha Ortodokse Serbe (KOS)

Zyrtarët kosovarë, përfshirë nënkolonelin Imer Avdiu, ish-shefi i Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës, dhe disa ekspertë ndërkombëtar me punë në Kosovë, pohojnë se asnjë grup tjetër në Kosovë nuk është mjet më i madh i ndikimit rus sesa Kisha Ortodokse Serbe, përkundër ndihmës më të madhe, bashkëpunimit dhe mbrojtjes së ofruar nga agjencitë perëndimore dhe misionet diplomatike. Çfarë e bën KOS-in aktorin më ideal në zbatimin e ndikimit rus? Sepse “KOS-i është shumë e informuar dhe ka shtrirjen më të mirë të çdo institucioni serb. Klerikët janë shumë të arsimuar, i kuptojnë pikëpamjet e tjera, por i përmbahen narrativës së tyre në kundërshtim me faktet. Ata janë mjaft manipulues”, sipas një zyrtari të lartë ndërkombëtar të sigurisë.<sup>95</sup>

Më 9 janar 2020, protestuesit serbë në Graçanicë, selia e Manastirit të Graçanicës, demonstruan në solidaritet me vëllezërit e tyre serbë në Mal të Zi kundër Ligjit të Malit të Zi për Lirinë e Fesë dhe Besimeve dhe Statusin Ligjor të Komuniteteve Fetare,<sup>96</sup> një ligj që KOS-i e konsideron mjet që vendi të konfiskojë pronat e kishës. Sipas Insajderi.com, duke cituar burime anonime nga sektori i sigurisë në Kosovë, mes protestuesve ishin tre agentë rusë, duke përfshirë një agjent të GRU-së i cili kishte hyrë në Kosovë nga Mali i Zi me dokumente të falsifikuara që e paraqisnin si të punësuar të UNMIK-ut. Të tre rusët, të shoqëruar nga një përkthyes serb, u panë duke vizituar Manastirin e Graçanicës më 8 dhe 9 janar 2020.<sup>97</sup> Përdorimi ose abuzimi i kishave të KOS-it për pritjen e rusëve nuk është gjë e re. Në vitin 2016, autoritetet e Malit të Zi çmontuan një grup bashkë-komplotistësh rusë dhe serbë që synonin të përmbysnin qeverinë në një përpjekje për të penguar anëtarësimin e Malit të Zi në NATO. KOS-i, teksa “nuk u përfshi drejtpërdrejt në përpjekjen për ekzekutim të komplotit ... [ishte] nikoqir i një takimi në orët e natës mes udhëheqësve të grushtit

90 Përkundër disa përpjekjeve për ta intervistuar z. Igor Simic (Lista Srpska, shefi i grupit parlamentar) mbi çështjen e ndikimit rus në Kosovë, dhe një takimi të planifikuar, intervista nuk u zhvillua.

91 Hoxhaj, Intervistë

92 Sipas një burimi të inteligjencës ndërkombëtare, zonja Kornilova është atasheu ushtarak i Rusisë në Kosovë.

93 Në një takim të ndjekur nga atasheu rus, serbëve lokalë që morën pjesë në takim iu shpërnda një anketë që shqyrtonte ndikimin rus në Kosovë. Në takimet pasuese me serbët lokalë, organizatori serb i takimit refuzoi ta shpërnda një anketë.

94 Anonim (oficer i inteligjencës). Intervistë me Elis Vllasin. Prishtinë, 6 shkurt 2020.

95 Anonim (Anëtar i lartë i stafit, organizatë ndërkombëtare e sigurisë në Kosovë). Intervistë me Elis Vllasin. Prishtinë, 6 shkurt 2020.

96 Zyra Ndërkombëtare për Lirinë e Fesë, pa datë “Raporti Ndërkombëtar për Lirinë e Fesë për vitin 2019: Mal i Zi”. Raporti Ndërkombëtar për Lirinë e Fesë për vitin 2019. Washington, D.C.: Departamenti i Shtetit i SHBA-ve. Qasur më 25 shtator 2020. <https://www.state.gov/reports/2019-report-on-international-religious-freedom/montenegro/>.

97 “Rusët pjesë e protestës në Graçanicë.” 2020. Insajderi Online. 12 janar 2020. <https://insajderi.com/ruset-pjese-e-protestes-ne-gracanice/>

të shtetit në manastirin e famshëm Ostrog të Malit të Zi pak para zgjedhjeve.<sup>98</sup>

Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë i mohon me forcë pretendimet se është një mjet përmes të cilit Rusia ushtron ndikim në Kosovë. Kur u pyet “në cilat mënyra, nëse ka të tilla, e kanë manipuluar rusët popullatën serbe të Kosovës ose Kishën Ortodokse Serbe (KOS) për të shërbyer si instrumente të ndikimit të tyre?” “Murgu kibernetik” i Kosovës Kryemurgu Sava Janjiç u përgjigj:

**“ Unë personalisht nuk jam në dijeni të ndonjë lloj ndikimi të tillë, veçanërisht jo brenda Kishës sonë ose përmes saj, siç sugjerojnë disa nga pyetjet tuaja. Ne ndajmë të njëjtin besim si Kisha e Rosisë, njësoj si me ortodoksët amerikanë, shqiptarë, grekë, rumunë, bullgarë, etj. Unë nuk jam në dijeni të ndonjë organizate bamirësie, shkolle, organizate kulturore ruse apo të ndonjë fondi që vjen nga Rusia në Kosovë. Qytetarët rusë nuk mund të hyjnë lehtë në Kosovë për shkak të kufizimeve të vizave. Kjo temë, sipas opinionit tim të fortë, duket të jetë shumë e ekzagjeruar dhe domosdoshmërisht çon në spekulime”.**

Kryemurgu Janjiç pohon se KOS-i në Kosovë ka një marrëdhënie më të ngushtë me kishat e tjera simotra (p.sh. Greqinë, Shqipërinë, Sllovakinë), sesa me KOR-in, pavarësisht interesimit të KOR-it për kushtet e serbëve. Kjo marrëdhënie konsiderohet e pakët:

**“[në] 20 vitet e fundit ka pasur vetëm disa vizitorë rusë në objektet tona. Kryesisht janë anëtarët e zyrës ruse në Kosovë të cilët shpesh marrin pjesë në meshën në Prishtinë me kolegët e tyre rumunë, grekë, bullgarë dhe kolegë të tjerë ose diplomatë të tjerë që janë të krishterë ortodoksë... Ka vërtet një interes të madh të Kishës Ruse për kushtet në të cilat jetojmë këtu në Kosovë dhe me të drejtë. Sidoqoftë, krahasuar me interesin nga media perëndimore, interesi i mediave ruse për të biseduar me përfaqësues të Kishës sonë në Kosovë duket i papërfillshëm”.**

Anëtarët e organizatave serbe të shoqërisë civile në Kosovë ndajnë ndjenjën e Kryemurgut Janjiç se KOS-i nuk është një aktor i angazhuar në propagandimin e ndikimit rus. Për një anëtar të OSHC-ve serbe në Kosovë, KOS-i është “një institucion i veçantë” i cili ka luajtur një rol qendror “në krijimin e shtetit modern serb” dhe në mbrojtjen e identitetit serb”. Si e tillë, “Kisha ka të drejtë veprimi” dhe “është shumë e vështirë të instrumentalizosh një institucion që e percepton veten si të pavdekshëm”. Për më tepër, nëse KOS-i po bashkëpunon me Rusinë “nuk do të thotë se ata janë duke shërbyer interesave ruse, por që mbase duhet ta kuptojmë në kontekstin e përdorimit të aleatëve nga KOS-i kur u shërben interesave të tyre”.<sup>99</sup>

98 Bajrović, Garčević, dhe Kraemer, Në fije të perit, 11.

99 Anonim (anëtar i një organizate serbe të Shoqërisë Civile). Intervistë me Elis Vllasin. Prishtinë, 4 shkurt 2020.

Për disa anëtarë të shoqërisë civile serbe, pretendimi kosovar dhe i të tjerëve se KOS-i punon për interesat e Ruisë, është i gabuar. Sepse, nëse Kisha do të ishte e interesuar të bënte atë që Rusia mund të preferonte që ata të bënin, kisha do të kishte mbështetur ndarjen e Kosovës përgjatë vijave etnike siç dëshironte presidenti i Serbisë, dhe se Asambleja e Shenjtë e Peshkopëve të KOS-it nuk do ta kishte refuzuar unanimisht ndarjen e Kosovës në baza etnike në nëntor 2018.<sup>100</sup> Sidoqoftë, komunikata e lëshuar pas asamblesë mbase e hedh poshtë pafajësinë e kishës në lidhje me ndarjen.

KOS-i e hedh poshtë ndarjen e Kosovës jo sepse beson në aftësinë e kosovarëve dhe serbëve për të jetuar së bashku në paqe, por sepse nuk dëshiron të pranojë një copë kur mund të pretendojë dhe shpresojë për tërë Kosovën. Teksa KOS-i e konsideron veten një institucion të pavdekshëm, për sa kohë që Kisha nuk bie dakord për ndarje, prita është që një ditë, kur SHBA-të dhe NATO-ja të largohen, Serbia do t'i vërë në jetë pretendimet e veta ndaj gjithë Kosovës. Ky durim strategjik bazohet në besimin e Kishës se mungesa aktuale e kontrollit në Kosovë e ka një paralele historike me pozicionin e saj gjatë periudhës Osmane. Serbia, serbët dhe Kisha e tyre ekzistojnë në Kosovë shumë përpara periudhës Osmane, dhe ata e priten me durim rënien e perandorisë Osmane, ndërkohë që zhvillojnë marrëdhëniet me fuqitë e tjera për të siguruar pretendimet e tyre në Kosovë kur të ikte Perandoria Osmane. Nëse ata arrijnë të presin ikjen e turkut, ata mund të presin edhe ikjen e amerikanit.

Në maj të vitit 2018, në mbledhjen e Asamblesë së Shenjtë, Peshkopët u bënë thirrje “shtetarëve tanë, të mos japin pëlqimin e tyre për tjetërsimin e Kosovës dhe Metohisë, pasi ajo që është marrë me forcë do të kthehet; megjithatë, ajo që i jepet një tjetri humbet përgjithmonë, dhe atë, serbët dhe Serbia nuk mund ta lejojnë”.<sup>101</sup> Pozicioni i kishës që nga çlirimi i Kosovës në 1999 ka qenë se “sovraniteti dhe integriteti i plotë i Serbisë në Kosovë dhe Metohi nuk mund të vihet në dyshim në asnjë rrethanë... Për Kishën tonë, Kosova dhe Metohia nuk ka qenë kurrë e as nuk mund të jetë kurrë vetëm një çështje politike zgjidhja e së cilës është nën monopolin ekskluziv të autoriteteve shtetërore.”<sup>102</sup>

Në këtë pikë, nuk ka asnjë dëshmi të fortë publike që e lidh KOS-in në Kosovë me rusët. Sidoqoftë, “mungesa e dëshmive nuk është dëshmi e mungesës”. Marrëdhënia “fetare” e Kishës me rusët që vizitojnë KOS-in në Kosovë vihet në pikëpyetje me forcë nga autoritetet kosovare dhe shoqëria civile, dhe nga disa në organizatat ndërkombëtare të sigurisë të pranishme në Kosovë. Disa nga të intervistuarit, ish-zyrtarë dhe zyrtarë aktualë dhe oficerë të sigurisë, pohuan se autoritetet qeveritare kanë prova të mjaftueshme që e lidhin KOS-in me ndikimin rus.

Në literaturën mbi ndikimin rus, Kisha Ortodokse Ruse luan një rol shumë të rëndësishëm në zgjerimin e shtrirjes dhe ndikimit të shtetit. KOR-i është shumë i politizuar dhe shërben për ta larë shtetin nga mëkatet e tij, mbase më shumë sesa për të ndihmuar spiritualitetin e përbashkët fetar. Sipas Qendrës për Studimin e Demokracisë, “[n]jë nga kanalet kyçe të fuqisë së mprehtë ruse në EJT ka qenë Kisha Ortodokse. Ajo luan rolin e një ndërmjetësi kyç shpirtëror për përhapjen e agjendës ruse në EJT [Evropa Juglindore], duke organizuar iniciativa të ndryshme nën një mbulesë

100 Shërbimi Informativ i Kishës Ortodokse Serbe. 2018. “Komunikata e Asamblesë së Shenjtë të Peshkopëve të Kishës Ortodokse Serbe për Kosovën dhe Metohinë.” Kisha Ortodokse Serbe. 8 nëntor 2018. [http://www.spc.rs/eng/communique\\_holy\\_assembly\\_bishops\\_serbian\\_orthodox\\_church\\_kosovo\\_and\\_metohija](http://www.spc.rs/eng/communique_holy_assembly_bishops_serbian_orthodox_church_kosovo_and_metohija).

101 Shërbimi Informativ i Kishës Ortodokse Serbe. 2018. “Komunikata e Asamblesë së Shenjtë të Peshkopëve për Kosovën dhe Metohinë.” Kisha Ortodokse Serbe. 13 maj 2018. [http://www.spc.rs/eng/message\\_holy\\_assembly\\_bishops\\_kosovo\\_and\\_metohija](http://www.spc.rs/eng/message_holy_assembly_bishops_kosovo_and_metohija).

102 Komunikata e Shërbimit Informativ të Kishës Ortodokse Serbe.

fetare. Në mënyrë paradoksale, kisha ortodokse ruse dhe kishat në shumë vende të EJT-së kanë qenë bastione të ish shërbimeve të sigurisë, duke e forcuar më tej ndikimin e Kremlinit.”<sup>103</sup>

Marrëdhënia e ngrohtë mes dy kishave simotra, KOR dhe KOS, shtrihet përtej çështjeve të besimit. Marrëdhënia politike mes dy institucioneve mund të përshkruhet në aspektin e objektivave kryesore të Fondacionit Ndërkombëtar për Unitetin e Kombeve të Krishtera Ortodokse (IFUOCN)<sup>104</sup> i cili bën thirrje për “[k]onsolidimin dhe koordinimin e përpjekjeve të komunitetit ndërkombëtar ortodoks për të zgjeruar dhe thelluar lidhjet e popujve sllavë... [dhe] [n]dërveprimin dhe bashkëpunimin me strukturat publike dhe fetare, shtetet dhe qeveritë lokale në Rusi dhe vendet e tjera për të zbatuar projektet dhe programet e Fondit.”<sup>105</sup> IFUOCN ka pasur zyra në Beograd dhe Novi Sad prej vitit 2005, sipas Vladimirov dhe të tjerëve.<sup>106</sup>

Një shembull i kohëve të fundit i koordinimit të ngushtë politik mes dy institucioneve ka të bëjë me statusin e Kishës Ortodokse të Ukrainës që synonte të shkëputej nga Rusia dhe të merrte statusin autoqefal. Teksa shumë Kisha Ortodokse autoqefale, përfshirë ato të Konstandinopojës, Greqisë dhe Aleksandrisë, e njohën autoqefalinë e Kishës Ortodokse të Ukrainës,<sup>107</sup> Patriarku Serb “e ka bërë të qartë publikisht se nuk do ta njohë pavarësinë ortodokse të Ukrainës”. Patriarku rus, në pritjen për Patriarkun e KOS-it më 29 janar 2019, e lidhi Ukrainën me Kosovën. “Patriarku Kiril i quajti përpjekjet për ta ndarë Kishën Ortodokse Ukrainase nga Kisha Ortodokse Ruse dhe Kosovën nga Serbia “hallka të të njëjtit zinxhir, në një farë kuptimi”.<sup>108</sup> Duke iu drejtuar Patriarkut Serb, Patriarku Kiril komentoi “ Ne e dimë që Kosova dhe Metohia luajnë rolin unik historik dhe shpirtëror në jetën e popullit serb, dhe e kuptojmë sa e vështirë është për të gjithë ata që e dinë historinë e Serbisë dhe Kishës Serbe të shikojnë të gjitha gjërat e këqija që ndodhin në këto toka. Megjithatë, Zoti po i udhëheq Kishat tona përmes kalvareve dhe, mbase, kjo është arsyeja pse ju, si askush tjetër, e kuptoni dhimbjen tonë të shkaktuar nga zhvillimet në Ukrainë.”<sup>109</sup> Duke falënderuar mikpritësin e tij, Patriarku Irinej i Serbisë, deklaroi “ kjo është toka [Kosova] e historisë sonë të lavdishme... Ne bëjmë gjithçka që mundemi për ta mbrojtur veten nga këto sulme dhe i varim shpresat tona të mëdha tek Rusia e madhe vëllazërore dhe tek ju, Shenjtëria juaj. Shpresojmë që me kontributin tuaj të jemi në gjendje ta mbrojmë Kosovën dhe Metohinë.”<sup>110</sup>

103 CSD. 2019. “Ndikimi ekonomik i Rusisë në Ballkan: Ndërhyrja ndaj fuqisë së mprehtë të Kremlinit.” Punim informativ për politikën nr. 89. Sofje: Qendra për Studimin e Demokracisë. <https://csd.bg/publications/publication/policy-brief-no-89-russias-economic-influence-in-the-balkans-tackling-kremlins-sharp-power/>.

104 Fondacioni Ndërkombëtar për Unitetin e Kombeve të Krishtera Ortodokse, është një OJQ e Kishës Ortodokse Ruse. Patriarku Kiril i Moskës dhe i Gjithë Rusisë shërben si Kryetar i Bordit të të Besuarve të Fondacionit Publik Ndërkombëtar për Unitetin e Kombeve të Krishtera Ortodokse.

105 “Deklarata e misionit”, pa datë Fondacioni Ndërkombëtar për Unitetin e Kombeve të Krishtera Ortodokse. Qasur më 25 shtator 2020. <http://www.ifuocn.com/>.

106 Qendra për Studimin e Demokracisë, Gjurma ekonomike ruse në Ballkanin Perëndimor.

107 Karelska, Khrystyna, dhe Andreas Umland. 2020. “Rusia gati të përshkallëzojë luftën kundër pavarësisë ortodokse të Ukrainës në vitin 2020.” Këshilli Atlantik. 2 janar 2020. <https://www.atlanticcouncil.org/blogs/ukrainealert/russia-set-to-escalate-fight-against-ukrainian-orthodox-independence-in-2020/>.

108 “Patriarku Serb krahason situatën në ortodoksinë ukrainase me shpërthimin e një bombe”. 2019. Feja. Interfax. 29 janar 2019. <http://www.interfax-religion.com/?act=news&div=14894>.

109 Shërbimi i Komunikimit DECR. 2019. “Primati i Kishës Ortodokse Ruse takohet me Shenjtërinë e Tij Patriarkun Irinej të Serbisë.” Kisha Ortodokse Ruse. 29 janar 2019. <http://www.patriarchia.ru/en/db/text/5364048.html>.

110 Po aty.

## Institucionet ndërkombëtare

Institucionet ndërkombëtare janë disa nga aktorët më të paanshëm në politikën ndërkombëtare. Kosova, ashtu si shumë shtete të reja që dolën nga shpërbërja e shteteve shumëkombëshe gjatë viteve 90-të, ka një numër të lartë të organizatave ndërkombëtare të pranishme në vend. Disa nga institucionet e pranishme (p.sh., UNMIK) janë globale; disa janë rajonale (p.sh. Bashkimi Evropian, OSBE); dhe disa janë shumë të specializuara (p.sh., KFOR, FMN). Institucionet ndërkombëtare në Kosovë janë të angazhuara në aspekte të ndryshme të shtetndërtimit: ndërtimi i paqes, demokratizimi; reformat ekonomike dhe sociale, dhe siguria.

Disa institucione, siç është misioni i KFOR-it nën udhëheqjen e NATO-s, shihen si më të besueshëm se institucionet vendase. Sipas një ankete të majit 2020 nga NDI, 80% e të anketuarve e vlerësuan KFOR-in <sup>111</sup> si të besueshëm, krahasuar me 54% që e shihnin Qeverinë e Kosovës si të tillë. Nivele të ngjashme të larta të besimit për KFOR-in mbështeten nga Barometri i Sigurisë i QKSS-së (2018) që tregon se 68.5% e njerëzve e ndajnë këtë ndjenjë. <sup>112</sup> Kur u pyetën për përkrahjen e institucioneve ndërkombëtare, kosovarët në shumicën dërrmuese përkrahin NATO-n (4.67 / 5), ku rezultate më të larta tregojnë përkrahje më të madhe.

Por jo të gjitha institucionet ndërkombëtare shihen me po aq kënaqshmëri sa NATO. Edhe pse institucionet ndërkombëtare janë aktorë me fushëveprim të përcaktuar nga misioni dhe janë shpesh neutralë, ato nuk janë të imunuara ndaj infiltrimit dhe shtrembërimit të misionit. Dy institucionet ndërkombëtare që akuzohen se janë manipuluar për t'u shërbyer interesave ruse janë Misioni i OKB-së në Kosovë (UNMIK) dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Roli i zgjeruar i Rusisë në këto dy institucione rezulton nga fuqia e vetos së Rusisë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së dhe sepse shtetet e OSBE-së gëzojnë status të barabartë dhe vendimarrja bëhet me konsensus. Për më tepër, si anëtare e këtyre institucioneve, Rusia ka qenë në gjendje të dërgojë zyrtarë për të shërbyer në të dy këto misione në Kosovë.

Zyrtarët kosovarë, kur u pyetën se cilat institucione ndërkombëtare në Kosovë, nëse ka, janë manipuluar për t'u shërbyer interesave ruse në Kosovë, unanimisht pajtohen se UNMIK-u është institucioni kryesor përmes të cilit punojnë rusët. Një shembull i fundit përfshin rastin e dy anëtarëve të stafit të UNMIK-ut që u arrestuan nga Policia e Kosovës më 28 maj 2019. "Policia arrestoi drejtuesin e ekipit rus të një zyre të UNMIK-ut në veriun e Kosovës, Mikhail Krasnoshchenkov dhe udhëheqësin serb të ndihmës së Programit të UNMIK-ut në të njëjtën zyrë, Dejan Dimiç... Policia e Kosovës pretendoi se Krasnoshchenkov ishte përpjekur të pengonte operacionin, duke përdorur automjetin e tij si barrikadë për t'i mos lejuar policisë të hyjë në një fshat." <sup>113</sup>

Nuk ka dakordësi për pretendimet se UNMIK-u është keqpërdorur nga rusët. Zyrtarët e UNMIK-ut dhe disa anëtarë të stafit ndërkombëtar pohojnë se z. Krasnoshchenkov nuk mori pjesë në protesta dhe akuzohet padrejtësisht se u ka ndihmuar serbëve në parandalimin e zyrtarëve policorë që të kryejnë detyrat e tyre. <sup>114</sup> Një zyrtar e përshkruan sjelljen e Mikhail Krasnoshchenkov gjatë protestave në Zubin Potok jo si të një nxitësi rus, por si të një personi i cili është i lidhur me

111 Sipas anketës së NDI-së, i vetmi institucion që shihet më i besueshëm se KFOR-i është Forca e Sigurisë së Kosovës.

112 Kur zbërthehen sipas përkatësisë etnike, 73.7% e shqiptarëve të Kosovës (të anketuarve) kanë besim tek KFOR-i.

113 Zivanovic, Maja. 2019. "Shefi i UNMIK kritikon Kosovën për arrestimet e stafit." Balkan Insight. 10 qershor 2019 <https://balkaninsight.com/2019/06/10/unmik-chief-criticises-kosovo-over-staffers-arrests/>.

114 "Situatë e brishtë në Kosovë pasi bastisja e policisë mbi krimin e organizuar çon në arrestim, lëndimi e personelit paqeruajtës, zyrtari i lartë politik i thotë Këshillit të Sigurimit." 2019. SC/13833. Nju Jork, NY: Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. <https://www.un.org/press/en/2019/sc13833.doc.htm>; Anonim (Anëtar i lartë i stafit, institucion ndërkombëtar në Kosovë). Intervistë me Elis Vllasin. Prishtinë, 28 janar 2020.

serbët lokalë dhe që u përpoq t'i mbrojë demonstruesit nga policia. Sidoqoftë, fakti që zyrtari është një oficer i pensionuar i Forcave Ajrore Sovjetike, një ish anëtar i GRU-së, dhe me përvojë në Sllavoninë Lindore, Kroaci, në vitet 90-të, e bën të vështirë që roli i tij të shihet si i një nëpunësi civil ndërkombëtar dhe të paanshëm. Të paktën një anëtar i stafit që punon për një organizatë ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë është dakord me zyrtarët e Kosovës që UNMIK-u ndikohet nga Rusia. <sup>115</sup>

Përkundër mohimit të ashpër zyrtar nga rusët ose zyrtarët e UNMIK-ut, deklaratat e zyrtarëve të Kosovës nuk do të duhej të hidheshin poshtë me lehtësi. Historiku i organizatave ndërkombëtare ka plot raste të manipulimit ose përdorimi të tyre nga fuqitë e mëdha, përfshirë edhe nga rusët/Bashkimi Sovjetik, për t'u shërbyer interesave të tyre. Një raport i vitit 1985 nga Komiteti i Zgjedhur i Senatit të SHBA-ve për Inteligjencën konstatoi se agjentët Sovjetikë "të caktuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara si nëpunës civilë ndërkombëtar raportojnë drejtpërdrejt në misionet Sovjetike... [dhe që] Sovjetikët kanë fituar avantazhe të konsiderueshme ndaj Perëndimit përmes taktikës së vendosjes së personelit dhe planeve të tyre të hollësishme për përdorimin e OKB-së për të arritur objektivat e politikës së jashtme dhe inteligjencës Sovjetike."<sup>116</sup> Kohët e fundit, në vitin 2010, agjentët federalë të SHBA-ve çmontuan një rrjet të agjentëve rusë që menaxhoheshin nga misioni rus në OKB, <sup>117</sup> dhe në vitin 2018, 12 operativë rusë u dëbuan nga SHBA-të sepse "kishin abuzuar me privilegjin e tyre të qëndrimit" në Organizatën e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork."<sup>118</sup>

Një institucion tjetër ndërkombëtar që spekulohet se është manipuluar nga rusët, nganjëherë, është misioni i OSBE-së në Kosovë.<sup>119</sup> Studimet tregojnë se Rusia "e përdor [OSBE-në] për shkëmbimin e informacionit dhe propagandën, për të legjitimuar pikëpamjet, për të tërhequr vëmendjen për shqetësimet e saj, për të bllokuar vendime të pafavorshme, për t'i detyruar të tjerët dhe për të bashkëpunuar në sfida të rëndësishme të "politikës së ulët".<sup>120</sup> Dëshmitë e fundit nga Ukraina dhe shtetet baltike tregojnë se OSBE-ja është përdorur nga rusët për t'u shërbyer interesave të tyre, duke u dhënë kredibilitet akuzave të z. Hoxhaj dhe gjetjeve shkencore. Në Ukrainë, "televizioni gjerman ARD ka paraqitur akuza të reja në lidhje me rolin e vëzhguesve rusë në mision; disa nga vëzhguesit rusë janë spiunë të lidhur me inteligjencën ushtarake ruse. Sipas raportit të ARD-së, këta individë rusë kanë mbledhur informacione personale në lidhje me monitorues të tjerë, duke përfshirë informacione personale si adresat, numrat e telefonit celular, dhe grupet e gjakut. Pa dalë aspak nga kallëpi i tyre, ata kanë mbajtur shënime edhe për çështje potencialisht të dëmshme ose komprometuese, siç janë përdorimi i alkoolit, aktiviteti seksual dhe çështjet financiare". <sup>121</sup>

115 Anonim (oficer i inteligjencës). Intervistë me Elis Vllasin. Prishtinë, shkurt 2020.

116 "Prezenca sovjetike në Sekretariatit e OKB-së." 1985. Komisioni i Përzgjedhur i Senatit për Inteligjencën S. PRT. 99-52. Uashington, D.C.: Senati i Shteteve të Bashkuara. <https://www.intelligence.senate.gov/sites/default/files/publications/9952.pdf>.

117 Lynch, Colum. 2010. "OKB-ja: Strofka e spiunëve rusë." Foreign Policy. 29 qershor 2010. <https://foreignpolicy.com/2010/06/29/the-u-n-russias-den-of-spies/>.

118 Gehrke, Joel. 2018. "Spiunët rusë abuzuan me privilegjet e tyre në OKB, thotë Departamenti i Shtetit." Washington Examiner. 26 mars 2018. <https://www.washingtonexaminer.com/policy/defense-national-security/russian-spies-abused-their-privileges-at-un-state-department-says>.

119 Hoxhaj, Enver. Intervistë me Elis Vllasin. Prishtinë, 22 janar 2020.

120 Kropatcheva, Elena. "Rusia dhe roli i OSBE-së në sigurinë evropiane: një Forum për dialog apo një Fushë Beteje e interesave?" Siguria evropiane 21, nr. 3 (2012): 370-394.

121 Niland, Paul. 2018. "Rusia nuk ka vend në misionin special të vëzhgimit të OSBE-së në Ukrainë." Këshilli Atlantik. 23 korrik 2018. <https://www.atlanticcouncil.org/blogs/ukrainealert/russia-has-no-place-in-the-osce-special-monitoring-mission-in-ukraine/>.

Në shtetet baltike, OSBE-ja është akuzuar për përhapje të ndikimit rus për t'i përlyer Lituanië, Letonië dhe Estoninë si vende ku shtypet pakica ruse. Në mbylljen e agjencisë së lajmeve Sputnik në Estoni, Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Mediave, Harlem Désir, shkroi në Twitter "I inkurajoj autoritetet [Estoneze] të përmbahen nga kufizimet e panevojshme në punën e mediave të huaja, pasi mund të ndikojnë në rrjedhën e lirë të informacionit"<sup>122</sup> në kundërshtim me provat që Sputnik e ka zakon të përhapë dezinformim dhe propagandën ruse. Në tetor 2019, "Désir organizoi një konferencë të OSBE-së mbi lirinë e mediave, sigurinë e gazetarëve, dezinformimin dhe lajmet e rreme në Moskë së bashku me Ministrinë e Jashtme Ruse."<sup>123</sup>

Teksa Rusia po e rrit ndikimin e saj në të gjithë Evropën, është e paarsyeshme të presësh që stafi pro-rus që shërben në institucionet ndërkombëtare në Kosovë të mbetet i paanshëm. Gjatë disa viteve të fundit është raportuar gjerësisht në media për oficerët ushtarakë të NATO-s të kapur duke spiunuar për Rusinë. Vetëm në vitin 2020 ka pasur raporte të shumta për personel ushtarak që veprojnë si agjentë rusë: një kolonel belg,<sup>124</sup> një oficer i lartë francez,<sup>125</sup> dhe një ish ushtar i Beretave të Gjelbra të SHBA-ve,<sup>126</sup> të gjithë të akuzuar ose nën aktakuzë për spiunim për Rusinë. Personeli i inteligjencës së NATO-s poashtu nuk ka qenë imun ndaj spiunimit rus, me një zyrtar të lartë të inteligjencës nga Portugalia të arrestuar për spiunim në vitin 2016.<sup>127</sup>

Z. Hoxhaj pranon që ekziston një farë shqetësimi pasi disa parti politike të Evropës Perëndimore (p.sh. AfD dhe DieLinke në Gjermani) bashkëpunojnë me partinë Rusia e Bashkuar dhe pasqyrojnë pozicionet ruse në lidhje me Kosovën. Gjatë dekadës së fundit, peisazhi politik evropian ka ndryshuar në mënyra që nuk janë parë me dekada, pasi partitë e majta dhe të djathta bashkëpunojnë hapur me partinë politike të Vladimir Putinit dhe marrin financime nga burimet ruse. Një lajm i Zërit të Amerikës (VOA) vëren se "ngritja e populizmit në Evropën Qendrore i ka shërbyer edhe Moskës, duke siguruar parti politike dhe politikanë dashamirës në mbarë kontinentin, duke përfshirë vendet e Bashkimit Evropian si Hungaria, Austria dhe Republika Çeke."<sup>128</sup> Në veçanti, infiltrimi i mundshëm ose kapja e institucioneve ndërkombëtare të pranishme në Kosovë, bëhen më shqetësues për shkak të qëndrimit të butë të mbajtur nga disa, pasi "jo të gjitha vendet anëtare të BE-së e shohin kërcënimin rus për atë që është. Disa besojnë se Rusia nuk ka ekonomi, vullnet politik për t'u angazhuar me forcë në Kosovë, ose diku tjetër në Evropë."<sup>129</sup>

122 Bakaitė, Jurga. 2020. "FAKTET E LRT. Si e detyroi Estonia Sputnik-un e Ruisë të mbyllej?" LRT anglisht. 20 shkurt 2020. <https://www.lrt.lt/en/news-in-english/19/1143881/lrt-facts-how-did-estonia-force-russia-s-sputnik-to-close>.

123 Po aty.

124 Rettman, Andrew. 2020. "A i mori Rusia sekretet e nivelit kozmik të NATO-s?" EUobserver. 29 maj 2020. <https://euobserver.com/foreign/148501>.

125 Euronews me AFP. 2020. "Oficeri i lartë ushtarak francez i dyshuar për spiunim për Rusinë." Euronews. 30 gusht 2020. <https://www.euronews.com/2020/08/30/senior-french-military-officer-suspected-of-spying-for-russia>.

126 Zyra e Punëve Publike. 2020. "Ish oficer i forcave speciale të ushtrisë i akuzuar për konspiracion spiunazhi rus." Departamenti i Drejtësisë i SHBA-ve. 21 gusht 2020. <https://www.justice.gov/opa/pr/former-army-special-forces-officer-charged-russian-espionage-conspiracy>.

127 Schindler, John R. 2016. "Skandali i ri i madh i spiunëve rusë në NATO". Observer. 25 maj 2016. <https://observer.com/2016/05/natos-big-new-russian-spy-scandal/>.

128 "Rritja e ndikimit rus në Ballkan, Baltik, Evropën Qendrore". 2018. Zëri i Amerikës (VOA). 9 tetor 2018. <https://www.voanews.com/europe/russian-influence-rising-balkans-baltics-central-europe>.

129 Anonim (Anëtar i lartë i stafit, organizatë ndërkombëtare e sigurisë në Kosovë). Intervistë me Elis Vllasin. Prishtinë, shkurt 2020.



# SHTIGJET E NDIKIMIT

Operacionet e suksesshme të ndikimit kërkojnë një terren shumimi që përmban tiparet më të këqija të pranishme në shoqëri. Studimet kanë treguar se në mungesë të lidhjeve etno-fetare, ideologjike ose historike, përbërësit e kërkuar për depërtimin e suksesshëm të ndikimit rus përfshijnë dobësitë strukturore. Një përfundim i përbashkët në të cilin kanë arritur disa anëtarë stafi ndërkombëtar me seli në Kosovë është se mangësitë më të mëdha në Kosovë që i mundësojnë Rusisë ushtrimin e ndikimit të saj armiqësor në Kosovë dhe në lidhje me Kosovën, janë dobësitë institucionale dhe shoqërore të pranishme në vend. Problemet me mungesën e stabilitetit elektoral për shkak të zgjedhjeve të shpeshta, mungesa e sovranitetit qeveritar në të gjithë territorin e Kosovës, siguria e dobët kibernetike, nivelet e ulëta të besimit mes shoqërisë dhe të njohurive për mediat, krijojnë hapësirë të madhe për Rusinë për ta dobësuar më tej shtetin, duke e portretizuar atë globalisht si një shtet të dështuar, dhe për t'i manipuluar kosovarët që të përvetësojnë pozicione ose besime që janë në kundërshtim me interesat e tyre kombëtare.



## Mungesa e stabilitetit elektoral

Në 12 vitet e saj që nga pavarësia, Kosova ka pasur 4 presidentë<sup>130</sup> dhe 5 kryeministra.<sup>131</sup> Të paktën në tre raste, kreu i shtetit ose kreu i qeverisë ka dalë nga procese zgjedhore me legjitimitet të diskutueshëm. Së pari, presidenti i dytë i Kosovës, z. Behgjet Pacolli, i hipur në detyrë më 22 shkurt 2011, shërbeu në detyrën e presidentit për vetëm 41 ditë para se Gjykata Kushtetuese e Kosovës ta shpallte zgjedhjen e tij "jokushtetuese".<sup>132</sup> Së dyti, pas shkarkimit të z. Pacolli, presidentja e tretë e Kosovës, znj. Ahtifete Jahjaga, u zgjodh në një mënyrë që vinte në dyshim legjitimitetin e saj. Në mungesë të një marrëveshje për të propozuar një president që do të votohej nga partitë e mëdha

130 Fatmir Sejdiu, Behxhet Pacolli, Ahtifete Jahjaga, dhe Hashim Thaçi.

131 Hashim Thaçi, Isa Mustafa, Ramush Hajradinaj, Albin Kurti, dhe Avdullah Hoti

132 "Vlerësimi Kushtetues i Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, Lidhur me Zgjedhjen e Presidentit". 2011. Rasti Nr. KO 29/11. Prishtinë: Gjykata Kushtetuese, Republika e Kosovës. [https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk\\_ko\\_29\\_11\\_eng.pdf](https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ko_29_11_eng.pdf).

politike, emri i zonjës Jahjaga u sugjerua nga Ambasadori i SHBA-ve në Kosovë, Christopher Dell,<sup>133</sup> dhe më pas u votua nga partitë kryesore politike.<sup>134</sup> Për fundi, kryeministri aktual Avdullah Hoti u zgjodh pas rrëzimit të qeverisë së udhëhequr nga ish kryeministri Albin Kurti me votim mosbesim më 25 mars, 2020, pas 52 ditësh në pushtet. Në vend që të shpalleshin zgjedhje të parakohshme pas shkarkimit të qeverisë, Gjykata Kushtetuese gjykoi se presidenti nuk ka pse të kërkojë zgjedhje të reja për sa kohë që kandidati për kryeministër i ka votat e shumicës së deputetëve.<sup>135</sup>

Mungesa e stabilitetit elektoral është një pengesë kryesore për aftësinë e qeverisë për koordinimin institucional për trajtimin e çështjeve madhore, siç është ndikimi rus. Ndërrimet e vazhdueshme të ministrave dhe mungesa e stafit të përhershëm të ekspertëve në nivelin ministror, sjellin ndërprerje në luftimin e kërcënimit rus. Një shembull i kësaj është “margjinalizimi i Këshillit të Sigurimit të Kosovës [KSK] sepse qeveritë e mëparshme nuk kanë dashur asnjëherë të krijojnë një KSK të fortë ku bashkohen shërbimet e ndryshme të sigurisë kombëtare. Si e tillë, KSK-ja nuk është në gjendje të koordinojë reagime efektive ndaj ndikimit rus”.<sup>136</sup>

Një shembull tjetër i mungesës së koordinimit institucional është kapja e pikave të kalimit kuftar të Jarinjës/Bernjakut, për të cilat Drejtori i PK-së pohoi se nuk e kishin informuar për vendimin për dërgimin e forcave të policisë në veri. Arrestimi i shtetasve turq dhe deportimi i tyre në Turqi për t’u përballur me akuzat e grushtit të shtetit kundër regjimit të Erdoganit, çoi në shkarkimin e Ministrit të Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, dhe Drejtorit të AKI-t, Driton Gashi, nga kryeministri Hajradinaj. Kryeministri pohoi se AKI nuk e informoi për operacionin për dëbimin e shtetasve turq të cilët ishin legalisht në Kosovë.<sup>137</sup> Presidenti Thaçi gjithashtu pohon se ai “u informua nga autoritetet përkatëse pas operacionit, se gjashtë shtetas turq u dëbuan në Turqi sot, nën justifikimin se nuk kishin leje ligjore për të qëndruar në Kosovë”.<sup>138</sup>

Koordinimi i dobët ndërinstitucional po pengon edhe marrëdhëniet me institucionet ndërkombëtare dhe dobëson vendosmërinë e aleatëve për t’i ndihmuar Kosovës për t’iu kundërvënë ndikimit rus. Zyrtarë të sigurisë të rangut të lartë e konsiderojnë të problematike që Policia e Kosovës ndërmerr një operacion të njëanshëm në komunat me shumicë serbe të veriut.<sup>139</sup> Mungesa e koordinimit me partnerët ndërkombëtarë i shqetëson zyrtarët e lartë të sigurisë, i siguron Serbisë dhe Rusisë një pretekst për përshkallëzim të sulmeve kundër Kosovës në nivelin global, si dhe për forcimin e fushatës ruse të dezinformimit. Operacionet policore në komunat me shumicë serbe janë përshkruar nga rrjetet propagandistike ruse, siç është Sputnik News, si

133 “Momenti kur Atifete Jahjaga u zgjodh presidente e Kosovës para 9 vjetësh.” 2020. Zëri. 7 prill 2020. <http://zeri.info/aktuale/339558/momenti-kur-atifete-jahjaga-u-zgjodh-presidente-e-kosoves-para-9-vjetesh-foto/>.

134 Znj. Ahtifete Jahjaga, para se të bëhej Presidente, ishte zyrtare e Policisë së Kosovës që ishte trajnuar në Akademinë e FBI-së. Ajo njihet si “Presidentja e Zarfif”. Bazuar në thashetheme [me shumë gjasa si hajgare], në një takim me Ambasadorin e SHBA-ve Dell për mungesën e marrëveshjes nga liderët kryesorë politikë në lidhje me një kandidat të dakorduar presidencial, Ambasadori Dell hapi sirtarin e tavolinës së tij, nxori një zarf që përmbante emrin e zonjës Jahjaga, dhe i përgëzoi për Presidenten e re.

135 “Vendimet nga sesioni i shqyrtimit i mbajtur më 28 maj 2020”. 2020. Rasti: KO 72/20. Prishtinë: Gjykata Kushtetuese, Republika e Kosovës. <https://gjk-ks.org/en/decisions-from-the-review-session-held-on-28-may-2020/>.

136 Anonim (këshilltar perëndimor i Qeverisë së Kosovës). Intervistë me Elis Vllasin. Prishtinë, 4 shkurt 2020.

137 PrishtinaPress.eu. 2018. “EKSKLUZIVE: Haradinaj Shkarkon Kreun e AKI-Së, Driton Gashin.” PrishtinaPress. 30 mars 2018. <http://prishtinapress.eu/2018/03/30/ekskluzive-haradinaj-shkarkon-kreun-e-aki-se-driton-gashin-dokument/>.

138 “Presidenti kërkon të sqarojë arsyet që çuan në dëbimin e qytetarëve turq.” 2018. Presidenti i Republikës së Kosovës. 29 mars 2018. <https://president-ksgov.net/en/news/the-president-demands-to-clarify-the-reasons-that-led-to-the-deportation-of-the-turkish-citizens>.

139 Anonim (Anëtar i lartë i stafit, organizatë ndërkombëtare e sigurisë në Kosovë). Intervistë me Elis Vllasin. Prishtinë, shkurt 2020.

“pushtim i zonave të populluara nga Serbët”.<sup>140</sup> Një shembull tjetër si përfiton Rusia nga mungesa e koordinimit ndërinstitucional, është transformimi në ushtri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Disa partnerë ndërkombëtarë u befasuan nga lëvizja e Kuvendit për miratimin e legjislacionit të kërkuar më 14 dhjetor 2018, duke marrë parasysh që në një “takim [të kohëve të fundit [5 dhjetor 2018] në selinë e NATO-s, zyrtarët e Kosovës mohuan çdo qëllim për ta transformuar FSK-në ushtri”.<sup>141</sup> Pas transformimit të FSK-së në ushtri, RT (ish Rusia Sot) publikoi dy artikuj që raportonin se “Kosova i ka shqetësuar pothuajse për të gjithë (përveç SHBA-ve) duke krijuar ushtrinë e saj, në një lëvizje që studiuesit e shohin si hakmarrje ndaj Serbisë dhe BE-së”<sup>142</sup> dhe se “ushtria e Kosovës shkakton një ndarje në Perëndim”.<sup>143</sup>

## Mungesa e sovranitetit në zonat me shumicë serbe

Një tjetër dobësi strukturore që mundëson ndikimin rus në vend i detyrohet paaftësisë së qeverisë për të konsoliduar sovranitetin e saj në të gjithë territorin e vendit. Sipas Varieteteve të Demokracisë (V-DEM), Kosova performon dobët si në stabilitetin politik ashtu edhe në masat për sundim të ligjit.<sup>144</sup> Për vitin 2018, Stabiliteti Politik<sup>145</sup> ishte në vlerën -0.6 pikë, ndërsa Sundimi i Ligjit<sup>146</sup> ishte -0.37, ku rezultate më të larta tregojnë stabilitet dhe sundim më të madh të ligjit.<sup>147</sup> Kosova, megjithëse është një shtet unitar, efektivisht funksionon si shtet konfederativ i përbërë nga zonat me shumicë shqiptare dhe komunat serbe. Në 10 komunat (me një sipërfaqe prej 1,708 km<sup>2</sup>, 17% e territorit të Kosovës) ku serbët përbëjnë shumicën e popullatës [të njohura edhe si komuna serbe], autoritetet qendrore kanë kontroll shumë të dobët. Në 4 komunat në veri, praktikisht nuk ka asnjë autoritet të qeverisë qendrore. Republika e Serbisë kontrollon çdo aspekt të autoritetit në ato komuna. Politikanët serbë punojnë dhe u binden udhëzimeve të autoriteteve të Serbisë dhe komunat drejtohen si një zgjatim i Serbisë. Zyrtarët policorë serbë i binden zinxhirit komandues të Kosovës dhe mbajnë shenjat e Policisë së Kosovës<sup>148</sup> në uniformat e tyre vetëm për aq sa i lejojnë autoritetet e Serbisë.

Megjithëse qeveria i ka në kontroll të gjitha pikat kufitare me Serbinë<sup>149</sup> (prej vitit 2011), Serbia dhe serbët kanë përdorur rrugët rurale për të kontrabanduar mallra dhe njerëz, përfshirë zyrtarë

140 “MPJ e Ruisë: Provokimi nga pushtimi prej Forcave Speciale të Kosovës i zonave të populluara nga serbët.” 2018.

Sputnik News. 1 tetor 2018. <https://sputniknews.com/europe/201810011068493542-russia-kosovo-serbia-invasion/>.

141 Anonim (zyrtar i një ambasade perëndimore). Intervistë me Elis Vllasin. Prishtinë, 23 janar 2020.

142 “Ushtria e Kosovës e mbështetur nga SHBA-të: një kërkesë nominale për shtetësinë dhe hakmarrje ndaj BE-së.” 2018.

RT International. 14 dhjetor 2018. <https://www.rt.com/news/446509-kosovo-army-sovereignty-revenge/>.

143 Clark, Neil. 2018. “Ushtria e Kosovës shkakton ndarje në Perëndim, por kush duhet të fajësohet?” RT International. 16 dhjetor 2018. <https://www.rt.com/op-ed/446591-kosovo-army-west-split/>.

144 Coppedge, Michael, dhe të tjerë/ 2020. “V-Dem [Vendi-Viti/Vendi-Data] Të dhënat V10.” Projekti Varietetet e Demokracisë (V-Dem). 2020. <https://doi.org/10.23696/vdemds20>. Të dhënat për Kosovën të marra duke përdorur Grafikon e Variablave (<https://www.v-dem.net/en/analysis/VariableGraph/>) dhe variabla të ndryshëm të zgjedhur nga “Komponentët”.

145 V-DEM kombinon disa tregues që matin perceptimin e gjasave që qeveria në pushtet të destabilizohet ose të rrëzohet nga mjete të mundshme jokushtetuese dhe/ose të dhunshme, përfshirë dhunën në familje dhe terrorizmin.

146 Shiko V-DEM V.10 Codebook.

147 Për të siguruar një pikë referimi, rezultati i stabilitetit politik të Sllovenisë është 0.91 (2018) dhe sundimi i ligjit është 1.06 (2018).

148 Në një takim në Shtërpce, zyrtarët Policisë së Kosovës (përfshirë komandantin e stacionit) të etnisë serbe u panë me shenja zyrtare të hequra.

149 Pikëkalimet kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak ishin jashtë kontrollit të qeverisë.

të qeverisë <sup>150</sup> në Kosovë, kur nuk ishin të disponueshme rrugët ligjore për shkak të kufizimeve të ndryshme. Kalimet veriore janë përdorur për hyrje të paligjshme nga rusët, përfshirë edhe nga gazetarët e Sputnik News <sup>151</sup>, si dhe nga ata të cilët “sistemi i navigimit i kishte dërguar gabimisht përtej kufirit me Kosovën”. <sup>152</sup> Një këshilltar politik i ish zëvendës kryeministrit gjithashtu konfirmon se ka pasur raste të rusëve që kalojnë përmes pikëkalimeve kufitare veriore në Kosovë duke përdorur letërnjoftime serbe.

## Siguria kibernetike

Depërtimi i internetit në Kosovë është 96%, me 81% të përdoruesve që e përdorin në baza ditore, sipas STIKK, <sup>153</sup> dhe ka 1.1 milion përdorues të rrjeteve sociale, nga të cilët afër një milion janë në Facebook. <sup>154</sup> Anketa tregon se interneti përdoret pothuajse plotësisht për komunikim nga 93%, kryesisht përmes Viber dhe Facebook. Megjithatë, përkundër përdorimit të tillë mbizotërues të domenit digjital, Kosova rezulton me kapacitet të ulët të sigurisë kibernetike qeveritare, sipas të dhënave të V-DEM. Në pyetjen “a ka qeveria staf dhe burime mjaft të afta teknologjiksht për të lehtësuar dëmet nga kërcënimet e sigurisë kibernetike?”, ekspertët i japin Kosovës një rezultat prej rreth 1.19 pikësh nga 4, kur rezultatet më të larta tregojnë burime më të mëdha nga qeveria për t’i luftuar sulmet kibernetike. <sup>155</sup> Partitë politike në Kosovë kanë tendencë të marrin rezultat të njëjtë për sa i përket kapacitetit të tyre për siguri kibernetike (rreth 1.27 nga 4 gjatë 4 viteve të fundit).

Në letër, Kosova po bën përparim në sigurinë kibernetike. Sipas një vlerësimi nga Qendra Globale për Siguri Kibernetike, “Kosova ka ndërmarrë hapa kritikë në ndërtimin e kapacitetit për siguri kibernetike, më e rëndësishmja ka miratuar Strategjinë e saj të parë Kombëtare për Siguri Kibernetike (SKSK) [e cila bën thirrje për] rishikimin e legjislacionit për krimin kibernetik, zhvillimin e një ligji gjithëpërfshirës ombrellë për sigurinë kibernetike, dhe krijimin e një baze ligjore për identifikimin e infrastrukturës kritike kombëtare.” <sup>156</sup> Megjithatë, në praktikë siguria kibernetike është e dobët, të paktën për sa i përket infrastrukturës kritike.

Sipas ekspertit për siguri kibernetike Drinor Selmanaj, <sup>157</sup> infrastruktura kibernetike e vendit vuan

150 Loxha, Amra Zejneli. 2013. “Vulin në veri përkundër ndalimit.” Radio Slobodna Evropa. 17 tetor 2013. <https://www.slobodnaevropa.org/a/vulin-usao-na-kosovo-uprkos-zabrani/25139606.html>.

151 Pantovic, Milivoje, dhe Die Morina. 2016. “Kosova dëbon dy reporterë të mbajtur në paraburgim”. Balkan Insight. 16 shtator 2016. <https://balkaninsight.com/2016/09/16/russian-and-ukrainian-journalists-reported-detained-in-kosovo-09-16-2016/>.

152 Shërbimi Ballkanik i RFE/RL. 2020. “Prokurori i Kosovës kërkon gjobë për rusët e akuzuar për kalimin e paligjshëm të kufirit.” Radio Evropa e Lirë/Radio Liria. 14 janar 2020. <https://www.rferl.org/a/prosecutor-in-kosovo-seeks-fine-for-two-russians-charged-with-illegal-border-crossing/30377219.html>.

153 “Penetrimi dhe përdorimi i internetit në studimin sasior kombëtar të Kosovës”. 2019. Shoqata e TIK-ut STIKK e Kosovës. [https://stikk.org/wp-content/uploads/2019/11/STIKK\\_IK\\_Report\\_Internet\\_Penetration\\_V3-final-1.pdf](https://stikk.org/wp-content/uploads/2019/11/STIKK_IK_Report_Internet_Penetration_V3-final-1.pdf).

154 Kemp, Simon. 2020. “Digital 2020: Kosova.” DataReportal. 18 shkurt 2020. <https://datareportal.com/reports/digital-2020-kosovo>.

155 Shiko V-DEM V.10 Codebook.

156 “Kosova ka ndërmarrë hapa kritikë në sigurinë kibernetike, thotë vlerësimi i modelit të ri të kapacitetit për siguri kibernetike.” 2020. Banka Botërore 29 qershor 2020. <https://www.worldbank.org/en/news/press-release/2020/06/29/kosovo-has-undertaken-critical-steps-in-cybersecurity>.

Raporti i plotë është i qasshëm në: [https://mzhe-ks.net/repository/docs/Cybersecurity\\_Capacity\\_Assessment\\_for\\_the\\_Republic\\_of\\_Kosovo\\_2019.pdf](https://mzhe-ks.net/repository/docs/Cybersecurity_Capacity_Assessment_for_the_Republic_of_Kosovo_2019.pdf)

157 Selmanaj, Drinor. Video-intervistë me Elis Vllasin. 21 shtator 2020. Drinor Selmanaj është themeluesi i institutit më të madh arsimor të mbrojtjes kibernetike në Evropën Juglindore, Akademia Kibernetike.

nga tre çështje kryesore. Së pari, vendit i mungon një sistem efikas dhe transparent i prokurimit, çka kërcënon sigurinë e menaxhimit të zinxhirit të furnizimit. Institucione të ndryshme u japin tenderë kompanive me çmime më të ulëta, dhe kështu blejnë produkte kritike nga furnitorë të palëve të treta në vend të shitësve të autorizuar, pa verifikuar burimin përfundimtar të furnizimit dhe integritetin e mallrave dhe shërbimeve. Së dyti, Ekipi i Kosovës për Reagim Emergjent Kompjuterik,<sup>158</sup> (KOS-CERT) përbëhet nga dy të punësuar me kohë të pjesëshme që ndihmojnë agjenci të ndryshme qeveritare me sigurinë kibernetike, përkundër kërkesave të mëdha për shkak të pandemisë globale Covid-19, përveç përgjegjësive të tjera. Kjo cenueshmëri është përqësuar nga mungesa e anëtarësimit të Kosovës në Korporatën e Internetit për Emrat dhe Numrat e Caktuar (ICANN)<sup>159</sup> pasi vendi nuk ka një spektër të dedikuar për Protokollin e Internetit (IP). Andaj, organizatat, bizneset, korporatat dhe institucionet e tjera që duan të jenë në internet duhet të regjistrohen në Serbi ose Shqipëri. Kur nga mbrojtësit e kërcënimeve kibernetike zbulohet një cenueshmëri ose një kërcënim që ndikon në këto institucione të Kosovës, ai njoftim shkon te CERT në Serbi dhe Shqipëri dhe jo në Kosovë, duke ulur kështu mundësinë e një përgjigjeje në kohë. Së fundmi, institucione të ndryshme qeveritare varen në masë të madhe nga kontraktorët e jashtëm (jo kosovarë) për shërbime të ndryshme të sigurisë kibernetike (p.sh., Maqedonia e Veriut, Bullgaria). Teksa mbështetja të burimet e jashtme është e pashmangshme për shkak të ekspertizës, “agjencitë nuk kanë mekanizëm të saktë të favorizimit të ekspertëve dhe kontraktorëve vendas. Ata gjithashtu nuk kanë asnjë mënyrë për të urdhëruar që kontraktorët e jashtëm të punojnë me kompani vendore për të krijuar talent dhe ekspertizë lokale.”<sup>160</sup>

Për më tepër, një ish këshilltar politik në Ministrinë e Punëve të Jashtme, pohon se Kosovës i mungon një sistem i sigurt telegrafik diplomatik. Komunikimet konfidenciale ndërmjet autoriteteve kosovare dhe përfaqësive diplomatike me seli në Prishtinë kryhen personalisht. Më e rëndësishmja, të dy burimet shprehin rezerva të thella ndaj serverëve të të dhënave të përdorura nga qeveria, pasi qeveria nuk mban serverët e saj të të dhënave, por këtë funksion e ka kontraktuar tek kompanitë private. Shqetësimi kryesor është se në një vend ku korrupsioni është i gjerë, një kompani private e besuar me të dhëna sekrete qeveritare lë derën e hapur për abuzimin e të dhënave ose manipulimin.

158 Një CERT është një ekip ose organizatë ekspertësh që merren me incidentet e sigurisë kompjuterike. CERT është “përgjegjës për mbrojtjen, zbulimin dhe reagimin ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike në një organizatë. Një CERT mund të përqendrohet në zgjidhjen e incidenteve siç janë thyerja e të dhënave dhe sulmet e mohimit të shërbimit, si dhe për sigurimin e alarmeve dhe udhëzimeve për trajtimin e incidenteve. CERT gjithashtu kryejnë fushata të vazhdueshme të vetëdijësimit të publikut dhe përfshihen në hulumtime që synojnë përmirësimin e sistemeve të sigurisë”, sipas <https://whatistechtarget.com/definition/CERT-Computer-Emergency-Readiness-Team>.

159 ICANN ndihmon në koordinimin e funksioneve të Autoritetit të Numrave të Caktuar në Internet (IANA), të cilat janë shërbimet kyçe teknike kritike për veprimet e vazhdueshme të librit themelor të adresave të Internetit, Sistemi i Emrit të Domenit (DNS). Funksionet IANA përfshijnë: (1) koordinimin e caktimit të parametrave të protokollit teknik duke përfshirë menaxhimin e adresës dhe domenit e nivelit më të lartë të zonës së parametrave të rutimit (ARPA); (2) administrimin e përgjegjësive të caktuara që lidhen me menaxhimin e zonës rrënjësore të DNS të Internetit, siç janë gjeneriket (gTLD) dhe domenet e niveleve më të larta të kodit i vendit (ccTLD); (3) alokimin e burimeve të numërimit në internet; dhe (4) shërbime të tjera.

160 Selmanaj. Intervistë

## Mungesa e besimit mes shoqërisë

Një dobësi e madhe shoqërore që mundëson ndikim armiqësor në Kosovë, rus apo tjetër, janë nivelet e ulëta të kapitalit shoqëror, sipas një zyrtari të një ambasade perëndimore me seli në Kosovë. <sup>161</sup> OECD-ja e përcakton kapitalin shoqëror si “rrjete së bashku me norma, vlera dhe kuptime të përbashkëta që lehtësojnë bashkëpunimin brenda ose mes grupeve... [Mund të kuptohen] si lidhjet, vlerat dhe kuptimet e përbashkëta në shoqëri që u mundësojnë individëve dhe grupeve të kenë besim tek njëri tjetri dhe kështu të punojnë së bashku.” <sup>162</sup> Bazuar në një anketë konfidenciale të kryer nga një ambasadë perëndimore, Kosova shfaq nivele “jo të shëndetshme” të mungesës së besimit mes shoqërisë. Rezultatet <sup>163</sup> tregojnë se kosovarët kanë më shumë besim tek anëtarët e familjes së ngushtë, kurse besimi në kategoritë e tjera të lidhjeve (familja e gjerë, lagje, komunitet, shoqëri në përgjithësi) bie ndjeshëm me secilën kategori që tregon distancën. Zyrtari i ambasadës perëndimore pohoi se kosovarët do ta kenë të vështirë ta luftojnë ndikimin armiqësor në një shoqëri ku askush nuk i beson askujt tjetër. Një anketë tjetër, e kryer nga Instituti Demokratik Kombëtar (NDI-Kosovë) mbështet pretendimet për besim të ulët shoqëror. Një anketë e kryer në vitin 2020 zbuloi se vetëm 5% e të anketuarve i identifikuan “të afërmit, miqtë, fqinjët, kolegët” si burime informacioni që njerëzit i besojnë më shumë, një rënie prej 4% nga 2019. Në vitin 2020, njerëzit në Kosovë i besojnë njëri tjetrit pak më shumë (5%) sesa u besojnë stacioneve televizive nga Serbia (2%).

Kosovarët jo vetëm që i besojnë shumë pak njëri tjetrit, por gjithashtu tregojnë mosbesim të thellë ndaj qeverisë. Të dhënat tregojnë se vetëm 16.2% e kosovarëve (të anketuarve) kanë besim tek qeveria, 18.4% kanë besim tek Kuvendi, dhe 40.6% u besojnë institucioneve lokale. Sipas anketuesit (QKSS) “mungesa e tillë e besimit mes qytetarëve në këto institucione thelbësore mund të ketë ardhur nga situata e dobët ekonomike e vendit, izolimi aktual i Kosovës - ngecja e procesit të liberalizimit të vizave, integritet evropian, dialogut me Serbinë, dhe mosanëtarësimi në organizata dhe mekanizma ndërkombëtarë.”

Ky mosbesim shoqëror ushqehet pjesërisht nga korrupsioni i përhapur, një përbërës kyç që bën të mundur ndikimin armiqësor. “Anketa e Opinioneve Publik të Kosovës” e kryer nga NDI (maj 2020) tregon se 51% e të anketuarve besojnë se vendi po shkon në drejtim të gabuar, me papunësinë (84%) dhe korrupsionin (53%) të identifikuar si dy problemet më të mëdha me të cilat përballet vendi. Një anketë e Barometrit të Sigurisë së Kosovës për vitin 2019 nga QKSS-ja tregon se sistemet e drejtësisë (Gjykatat dhe Prokuroria) perceptohen si institucionet më të korruptuara nga përkatësisht 53.5% dhe 51% e të anketuarve. Anketa e NDI-së për vitin 2020, identifikon edhe Presidencën si një institucion shumë të korruptuar, me të anketuarit që e vlerësojnë atë me 3.34 nga 5. Rezultatet më të larta tregojnë nivele më të mëdha të korrupsionit. Sipas të njëjtës anketë, partitë politike dhe zyra e presidentit konsiderohen ndër institucionet më pak të besueshme.

161 Anonim. Intervistë me Elis Vllasin. Prishtinë, 23 janar 2020.

162 “Çfarë është kapitali shoqëror?” pa datë OECD Insights: Kapitali njerëzor. <https://www.oecd.org/insights/37966934.pdf>.

163 Kur kërkova të shoh rezultatet e anketës, më thanë se të dhënat janë konfidenciale dhe nuk mund të ndahen.

## Njohuritë për mediat

Indeksi i Njohurisë për Mediat 2019 (MLI) renditi Finlandën, Danimarkën, Holandën, Suedinë dhe Estoninë si vendet me njohuritë më të lartë për mediat dhe “të pajisura më mirë për t’i bërë ballë ndikimit të lajmeve të rreme për shkak të cilësisë së arsimit, mediave të lira dhe besimit të lartë mes njerëzve”.<sup>164</sup> Sipas “Thjesht mendo për këtë. Gjetjet e Indeksit të Njohurive për Mediat 2019,<sup>165</sup> ” vendet me performancë më të dobët janë tepër të grumbulluara gjeografikisht në Ballkanin Perëndimor.<sup>166</sup> Gjetjet tregojnë se: 1) sa më të larta perceptimet e korrupsionit në një vend, aq më të ulëta janë rezultatet e tij në MLI; 2) Sa më i lartë të jetë mosbesimi tek gazetarët në një vend, aq më i ulët është rezultati në MLI; dhe 3) Sa më i lartë mosbesimi tek shkencëtarët në një vend, aq më i ulët është MLI.

Përveç nxitjes së mungesës së besimit mes shoqërisë, korrupsioni ka një efekt korroziv në njohuritë për mediat, çka e bën ndikimin rus në Kosovë edhe më të lehtë. Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International,<sup>167</sup> Kosova renditet në mesin e vendeve më të korruptuara në botë. Në vitin 2019 shënoi 36 pikë, në 2017 (39) dhe 2012 (34). Një anketë e kryer nga QKSS-sa tregon se qytetarët e Kosovës e shohin korrupsionin si endemik, me 89.1% të të anketuarve që e shohin “si kërcënimin e brendshëm më të rrezikshme me të cilin përballet Kosova”.<sup>168</sup> Freedom House në raportin e vet vjetor për vendin pohon,

**“[k]orrupsioni mbetet një problem serioz dhe korniza institucionale për ta luftuar është e dobët... Autoritetet kanë treguar pak angazhim për të ndjekur penalisht korrupsionin e nivelit të lartë, dhe kur zyrtarët e lartë ndiqen penalisht, dënimet janë të rralla. Teksa partitë politike u angazhuan publikisht për ta luftuar korrupsionin gjatë fushatës zgjedhore 2019, shumë politikanë që ishin implikuar më parë në sjellje korruptive gjendeshin në fletëvotim.”<sup>169</sup>**

Nivelet e ulëta të njohurive për mediat në Kosovë, të përkeqësuar nga cilësia e dobët e arsimit dhe mungesa e lartë e besimit tek gazetarëve, e bëjnë më të lehtë për një aktor të merret me manipulime. Sipas Programit të OECD-së për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve 2018 (PISA), Kosova është ndër vendet me performancën më të keqe për sa i përket leximit, matematikës dhe

164 Lessenski, Marin. 2019. “Indeksi i njohurive për mediat 2019: Thjesht mendo për këtë.” Instituti i Shoqërisë së Hapur Sofje. 29 nëntor 2019. <https://osis.bg/?p=3356&lang=en>.

165 Po aty.

166 Rezultatet e indeksit: Shqipëria 22, Maqedonia e Veriut 12, Bosnja 24, Serbia 31, Mali i Zi 29. Edhe pse raporti nuk rendit ndonjë të dhënë për Kosovën, nuk është e paarsyeshme të pritet që edhe Kosova të ndodhet në këtë grup.

167 Transparency International. Rezultati i IPK-së lidhet me perceptimet e shkallës së korrupsionit siç shihet nga afaristët, analistët e risqeve dhe publiku i gjerë, dhe varion mes 100 pikë (shumë i pastër) dhe 0 pikë (shumë i korruptuar). Renditje globale e Kosovës: 101/198 (2019); 93/198 (2018); 85/198 (2017).

168 Marku, Donika. 2018. “Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i Tetë.” Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Nëntor 2018. <http://www.qkss.org/en/Reports/Kosovo-Security-Barometer-Eighth-Edition-1163>.

169 “Liria në botë 2020: Kosova.” 2020. Freedom House. 2020. <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2020>.

shkencës. Renditet e 75-ta nga 77 vende.<sup>170</sup> Kosova nuk shkon mirë as për sa i përket mediave dhe mungesës së besimit tek gazetarët. Sipas të dhënave të V-DEM mbi anshmërinë e mediave, Kosova prej vitit 2008 ka shënuar ndërmjet 2.58 dhe 2.67 nga 4. Mediat lokale shfaqin gjithashtu nivele të larta të vetë-censurës së mediave, me V-DEM që raporton rezultate mes 1.2-1.82 nga 3<sup>171</sup> që nga pavarësia e vendit.

Kosovarët janë veçanërisht mosbesues ndaj burimeve jo televizive, me rrjetet sociale dhe portalet e lajmeve të konsideruara të besueshme respektivisht nga 15% dhe 8% e popullatës. Sipas anketës së NDI-Kosovë, kur u pyetën nëse “disa ueb faqe/portale të lajmeve online raportojnë informacion të rremë?” 43% e të gjithë të anketuarve pohuan “Po, rregullisht”, një rritje prej 11% nga viti 2019. Një pjesë tjetër prej 38% u përgjigjën se ueb faqet/portalet e lajmeve online raportojnë informacione të rreme “herë pas here”. Në vitin 2019, 31% e të anketuarve u përgjigjën se “burimet kryesore tradicionale të lajmeve si TV dhe gazetat raportojnë lajme të rreme” rregullisht, dhe 48% pohuan se e bëjnë këtë “herë pas here”. Kur u pyetën nëse këto storie të lajmeve të rreme janë të qëllimshme, 40% u përgjigjën: “Me qëllim për të shtyrë një agjendë.” Besimi i ulët ndaj burimeve të lajmeve (online) është mjaft i dëmshëm për reziliencën ndaj manipulimeve, pasi që portalet e lajmeve online (Gazeta Express, Telegrafi dhe Indeks online) janë ndër 10 artikujt më të kërkuar në Kërkimin në Google.<sup>172</sup>

Kosovarët janë shumë të brengosur për dezinformimin dhe presin që udhëheqësit e tyre të ndërmarrin hapat e duhur për ta parandaluar,<sup>173</sup> megjithatë, udhëheqësit janë të papërgatitur për ta penguar dezinformimin pasi ata janë kryesisht përgjegjës për krijimin e një “toke pjellore” ku dezinformimin ha hedhur rrënjë. Hulumtimi për dezinformimin në Kosovë, i kryer nga NDI-Kosova, zbulon se “aktorët politikë në të gjithë spektrin... i shfrytëzojnë portalet e lajmeve si faqe dezinformimi dhe gjenerojnë rregullisht dezinformata, duke u përpjekur të arrijnë përfitime afatshkurtra politike dhe të tërheqin elektoratin”.<sup>174</sup>

Sidoqoftë, udhëheqësit nuk janë të vetmit që nuk janë të gatshëm të kundërveprojnë ndaj dezinformimit. Edhe publiku është shumë i papërgatitur. Kosovarët piren të mendojnë se janë aq të zgjuar sa të mos bien pre e fushatave dezinformuese ruse. Në përgjithësi, njerëzit janë të vetëdijshëm për lajmet e rreme dhe dezinformimin, por nuk janë rezilientë ndaj fushatave të sofistikuara të dezinformimit. Hulumtimi i NDI-Kosovë zbuloi se “pjesëmarrësit [kanë] vështirësi më të mëdha për të identifikuar raste më të avancuara ose të sofistikuara të dezinformimit, siç janë videot e manipuluar”<sup>175</sup>

Mungesa e besimit tek mediat e lë derën hapur edhe për manipulim të mundshëm të mediave. Rusët nuk janë pa përvojë në kërkimin e blerjes së ndikimit mediatic. Në Maqedoninë e Veriut, “agjentët rusë janë përpjekur të ndikojnë dhe t’u ofrojnë fonde mediave maqedonase, përfshirë ato që synojnë pakicën shqiptare të vendit, në mënyrë që të përhapin “informacion dhe dezinformim” në mbështetje të qëllimeve të politikës ruse” sipas OCCRP.org. Megjithëse nuk ka asnjë provë të donjë ndikimi të drejtpërdrejtë rus mbi mediat në Kosovë, mënyra si trajtohen storjet për Rusinë

170 “Përmbledhjet Ekzekutive të Kombinuara të Rezultateve të PISA 2018, Vëllimi I, II dhe III.” 2019. OECD. [http://www.oecd.org/pisa/Combined\\_Executive\\_Summaries\\_PISA\\_2018.pdf](http://www.oecd.org/pisa/Combined_Executive_Summaries_PISA_2018.pdf).

171 Rezultatet më të larta (3) tregojnë se nuk ka vetë-censurë.

172 Kemp, Simon. 2020. “Digital 2020: Kosova.” DataReportal. 18 shkurt 2020. <https://datareportal.com/reports/digital-2020-kosovo>.

173 Kurhasani, Valon. Drejtori i Programit, NDI-Kosovë. Intervistë me Elis Vllasin. Prishtinë, 4 janar 2020.

174 Kurhasani, Valon. 2019. “Konferenca për dezinformimin”. Prishtinë, Kosovë: Instituti Demokratik Kombëtar - Kosovë.

175 Po aty.



nuk është reflektim i pikëpamjeve kosovare mbi Rusinë dhe ndikimin rus. Valon Kurhasani i NDI-Kosovë deklaroi se disa media, pa dashje, e bëjnë punën e Ruisë për të paraqitur një pamje të favorshme të Ruisë dhe Presidentit Putin, dhe shumë media kanë botuar në mënyrë jo kritike storje mbi “fuqinë ushtarake të Ruisë dhe sa i fortë dhe atletik është Putini” sepse postojnë lajme pa i atribuuar burimet.

Kundërveprimi ndaj manipulimit të mediave, posaçërisht ndaj operacioneve të sofistikuar të favorizuara nga rusët, është veçanërisht sfiduese në mjedisin mediatic të Kosovës për dy arsye. Së pari, Kosovës i mungon korniza legjislative e nevojshme për të pasur media transparente. Sipas NDI-Kosovë dhe ekspertës së mediave Profesoreshë Remzie Shahini-Hoxhaj, ligjet ekzistuese nuk u kërkojnë mediave të zbulojnë të dhëna të pronësisë ose burimeve të financimit. Kjo e bën problematike të konstatosh nëse një kompani e huaj zotëron ndonjë organizatë mediatike. Në një vend të vogël siç është Kosova, me një treg të vogël dhe një numër disproportionalisht të lartë të mediave (21 televizione, 82 radio stacione, 20 portale lajmesh), transparenca e të hyrave do të ndihmonte në luftimin e manipulimit të mediave.<sup>176</sup> Së dyti, niveli i profesionalizmit gazetaresk është i dobët, pasi gazetarëve u mungon trajnimi dhe shkathhtësitë e kërkuara për t’u marrë me verifikimin e fakteve, për të ndjekur storje të rreme, për t’u qasur një lajmi në mënyrë kritike, ose për ta raportuar burimin e lajmit nëse huazohet nga media të tjera.

Një studim akademik nga Mavraj dhe Tahiri<sup>177</sup> që shqyrton mbulimin e storjeve ruse në tre media të lajmeve të Kosovës (RTK, Koha dhe Gazeta Express) nga dhjetori 2017 deri më 28 shkurt 2018 zbulon se Gazeta Express, më shumë se dy media të tjera “ka tendencë të ndërtojë imazhin afirmativ të udhëheqjes ruse, veçanërisht në lidhje me portretizimin e Vladimir Putinit”. Një analizë mediatike e storjeve mbi Rusinë zbulon se Gazeta Express kishte 47 storje të favorshme dhe 44 storje të pafavorshme, dhe 110 nga 151 storje nuk kishin referencë (burim, gazetar, datë) për storjen e raportuar.

176 Hoxhaj, Remzie Shahini. 2020. “Peisazhet mediatike në Kosovë pas vitit 1989: Kosova si rast unik i kulturës mediatike në Ballkan”. [Draft i pabotuar].

177 Tahiri, Lindita, dhe Muhamet Mavraj. 2019. “Imazhi i Ruisë në diskursin mediatic në Kosovë: Krahasimi mes medias publike dhe private.” Informacijos Mokslai 86:23–40.

# KONKLUZIONE

---

Rusia ka ushtruar tradicionalisht një ndikim të madh në Ballkan. Shkalla e ndikimit të saj ka ndryshuar me kalimin e kohës dhe varet nga aleancat lokale, aftësitë e veta dhe fuqitë e tjera të mëdha me të cilat përballet në rajon. Tradicionalisht, ndikimi i Rusisë ka qenë më i madh në mesin e popullatës ortodokse sllave, serbëve, maqedonasve, malazezëve dhe bullgarëve. Sidoqoftë, herë pas here, ky ndikim është shtrirë në bashkë-fetarë josllavë, por ortodoksë (p.sh., grekë, rumunë) dhe regjime dhe grupe të rreshtuar ideologjikisht (p.sh., Shqipëria deri në ndarjen Sovjetiko-Shqiptare në 1961; grupet Marksiste-Leniniste në Kosovë në vitet 1970-1980).

Pra, cili është niveli i ndikimit të Rusisë në Kosovë? Në Kosovë, është e pamundur të arrihet nivel maksimal i ndikimit, për shkak të mungesës së lidhjeve mbi baza etnike, politike ose ekonomike. Së pari, shumica e popullatës së Kosovës është shqiptare (popullatë jo sllave etnikisht dhe jo me fe ortodokse). Teksa në të kaluarën disa individë janë bashkuar në disa grupe me afinitet ideologjik për versionin stalinist të komunizmit, shumica absolute e popullatës kosovare nuk shpreh afinitet për Rusinë ose rusët. Për kosovarët, Rusia dhe rusët përfaqësojnë prapambetjen (kulturore, politike dhe ekonomike). Për më tepër, si aleatja e madhe e Serbisë, Rusia është kthyer në simbol të sprovave dhe vuajtjeve të kosovarëve të paktën që prej viti 1989 (humbja e autonomisë). Së dyti, mbi baza politike, Rusia ka një hapësirë shumë të ngushtë të ndikimit. Kosova e kërkon të ardhmen e saj në anëtarësimin në institucionet politike perëndimore (p.sh. BE, NATO, dhe të tjera). Në të njëjtën kohë, institucionet e drejtuara nga Perëndimi për 21 vitet e fundit kanë bërë një përpjekje të përbashkët për ta socializuar politikisht Kosovën në mënyrë që të jetë një vend liberal politikisht dhe me një ekonomi tregu. Prania e NATO-s dhe BE-së e kufizon hapësirën e veprimit për Rusinë. Largimi i forcave ushtarake ruse (pjesë e KFOR) në vitin 2003 dhe anshmëria e plotë dhe e hapur e Rusisë që favorizon Serbinë në forume ndërkombëtare të thirrura për zgjidhjen e konfliktit Kosovë-Serbi prej vitit 1999, i lë pak hapësirë Rusisë që të ketë ndonjë ndikim pozitiv mbi kosovarët dhe Kosovën. Qasja e Rusisë për mbështetjen e çdo rezolutë vetëm për aq kohë sa ka mbështetjen e plotë të Serbisë, e bën të vështirë për Rusinë të luajë një rol domethënës dhe me ndikim të ngjashëm si në Greqi dhe Sllovaki, vende të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, por që luajnë rol konstruktiv në varësi të pajtueshmërisë serbe.

Shtetet e fuqishme ushtrojnë ndikim edhe veç për shkak të fuqisë së tyre. Prandaj, do të ishte iluzion të presim që Rusia të ketë zero ndikim në Kosovë. Rusia nuk ka pse të ndër marrë ndonjë veprim konkret për ta shfaqur ndikimin e vet. Një nga zbulimet më interesante ketijë hulumtimi 6-javor në Kosovë ishte qëndrimi mospërfillës i shumë prej personave (në biseda formale dhe joformale) për masën e ndikimit rus. Duket se ekziston perceptimi se manipulimi rus nuk mund të shtrihet mbi kosovarët për shkak të armiqësisë së tyre ndaj Rusisë. Sidoqoftë, marrë parasysh ato që dimë për operacionet e ndikimit rus në Perëndim gjatë dy dekadave të fundit, përfshirë shtrirjen dhe ndikimin e tyre në zgjedhjet në SHBA në vitin 2016, është shumë e vështirë që kosovarët të mos mund të manipulohen për t'i shërbyer ndonjë interesi. Dobësia institucionale dhe mungesa e besimit mes shoqërisë, të kombinuara me një popullatë mikpritëse serbe të Kosovës, i japin Rusisë hapësirë manovrimi për të ndikuar në zhvillimin në vend dhe globalisht për Kosovën.

Ky studim tregon se Rusia mund të kategorizohet të ketë një nivel mesatar të ndikimit. Në Kosovë, operacionet e saj të ndikimit janë kryesisht të kufizuara tek serbët e Kosovës (me lejen e Serbisë), që ata të vazhdojnë të luajnë rolin e prishësit në politikën e brendshme: për të parandaluar zgjerimin e sovranitetit në zonat me shumicë serbe dhe për të penguar punën e qeverisë kombëtare. Ato nuk synojnë ndikimin tek kosovarët ose qeveria kombëtare për të përvetësuar ndjenja ose politika pro-ruse.

Por në nivelin global Rusia ka qenë shumë efektive në ndikimin e saj në operacionet që targetojnë Kosovën. Siç vuri në dukje Enver Hoxhaj, "goditjet më të rënda ruse nuk kanë qenë në kontekstin e brendshëm, por në sferën ndërkombëtare, ku rusët kanë ndikim që e dëmton Kosovën". Fuqia e vetos së Rusisë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së e mban Kosovën larg OKB-së dhe shumë institucioneve të tjera ndërkombëtare ku anëtarësimi në OKB është parakusht. Ajo e ka përdorur rolin e saj dominues në hapësirën post-Sovjetike për të parandaluar që ish republikat Sovjetike ta njohin Kosovën, dhe pozitën e saj në komunitetin ndërkombëtar për të lobuar që shtetet ta tërheqin njohjen e tyre të Kosovës ose të mos ta pranojnë Kosovën në institucionet ndërkombëtare (që nuk kërkojnë anëtarësim në OKB) Së fundmi, ajo i ka përdorur në mënyrë efektive mediat ruse me shtrirje globale për të formuar një narrativë negative për Kosovën

# REKOMANDIME

---

**Për Qeverinë e Kosovës:** të pengohet ndikimi armiqësor i cilitdo vendi nuk është detyrë e lehtë. Mbrojtja e vendit dhe qytetarëve të saj nga ndikimi rus është detyrë me përmasa epike, veçanërisht duke pasur parasysh pamundësinë e fuqive të mëdha si SHBA-të dhe Mbretërisë së Bashkuar për t'iu kundërvënë me sukses manipulimeve, propagandës dhe dezinformimit rus. Sidoqoftë, qeveria nuk është plotësisht e pafuqishme për kundërveprimin ndaj ndikimit rus.

- **Së pari**, qeveria nuk mundet dhe nuk do të duhej ta luftonte e vetme ndikimin rus (ose atë të vendeve të tjera armiqësore). Ajo duhet të përfshijë akademikët, shoqërinë civile dhe qendrat studimore në këtë përpjekje. Qendrat studimore, si Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Kipred dhe Instituti Demokratik Kombëtar-Kosovë, janë veçanërisht të përshtatshme për të kontribuar në këtë detyrë duke marrë parasysh njohuritë e tyre për propagandën, dezinformimin dhe kërcënimet ruse ndaj sigurisë. Mbi të gjitha, në vendet perëndimore politikëbërja nuk lind në sallat e qeverisë, por në institute të ndryshme.

- **Së dyti**, qeveria nuk do të jetë efektive nëse vazhdon ta trajtojë si sekret qeveritar çdo akt të ndikimit armiqësor. Ajo duhet të adoptojë të njëjtën qasje si ajo e vendeve të Evropës Veriore dhe t'i shpallë aktivitetet e ndikimit rus në raportet vjetore publike.<sup>178</sup> Kjo e ngre nivelin e vetëdijesimit në mesin e popullatës për numrin e ngjarjeve dhe nivelin e luftës informative ndaj së cilës është e ekspozuar, në mënyrë që njerëzit të dinë si të reagojnë.

- **Së treti**, agjenci të ndryshme të Kosovës duhet të forcojnë marrëdhëniet dypalëshe me shtetet baltike dhe vendet e Evropës Veriore, veçanërisht në fushën e pengimit të luftës hibride, dhe të mësojnë nga praktikat e tyre më të mira për mbajtjen e distancës nga ndikimi rus.

- **Së katërti**, Kosova do të ishte në një pozitë shumë më të mirë për ta luftuar ndikimin armiqësor nëse adopton strategjinë e mbrojtjes kolektive të Finlandës dhe angazhon studentë në çdo nivel (nga shkolla fillore deri në universitet) përmes një planprogrami kombëtar që ngre njohuritë për informacionin dhe forcon shkathtësitë e të menduarit kritik.<sup>179</sup> Për më tepër, qeveria, shoqëria civile dhe mediat duhet të bashkëpunojnë për të rritur nivelin e profesionalizimit dhe transparencës në media, në mënyrë që të zvogëlohet aftësia e aktorëve të huaj për t'i manipuluar mediat dhe të nxitet një mjedis publik më i shëndetshëm që nuk krijon dezinformim. Së bashku, palët duhet të miratojnë një politikë që serbëve të Kosovës u ofron alternativa mediatike ndaj burimeve serbe pro-ruse në të cilat ata mbështeten, për të shmangur manipulimet e mëtejshme nga Rusia.

---

178 Karlsen, Përça dhe sundo.

179 Henley, Jon. 2020. "Si e nis Finlanda luftën e saj kundër lajmeve të rreme në shkollat fillore." Guardian, 29 janar 2020, faqja e Lajmeve nga Bota. <https://www.theguardian.com/world/2020/jan/28/fact-from-fiction-finlands-new-lessons-in-combating-fake-news>.

• **Së pesti**, qeveria duhet që së paku të ndërmarrë reforma institucionale që forcojnë koordinimin ndërinstytucional për çështjet e sigurisë. Duke qenë se sistemi politik parlamentar i vendosur në Kosovë nuk krijon stabilitet të plotë elektoral, qeveria duhet të ketë një staf ekspertësh të përhershëm në ministritë dhe agjencitë kyçe të sigurisë që kanë autoritetin për t'iu kundërvënë kërcënimeve. Qeveria duhet t'i përqendrojë energjitë e saj në parandalimin e ndikimit rus dhe të armiqësive të tjera, në vend që të punojë kaq fort për dezinfektimin e pasojave të veprimeve armiqësore.

**Për komunitetin ndërkombëtar:** organizatat ndërkombëtare dhe misionet diplomatike në Kosovë janë të pozicionuar në mënyrë unike për ta degraduar ndjeshëm ndikimin rus në Kosovë. Ndikimi rus në vend nuk duhet të konsiderohet se synon vetëm Kosovën, dhe si i tillë nuk ka rëndësi për SHBA-të, BE-në, NATO-n dhe të tjerët. Përkundrazi, shtetet perëndimore dhe organizatat ndërkombëtare duhet të shkojnë drejt ndalimit të ndikimit rus në Kosovë, pasi Rusia synon ta parandaloj zgjerimin e SHBA-ve, NATO-s dhe BE-së në rajon. Vendet dhe organizatat

• **E para** dhe më e rëndësishmja, çelësi absolut për zvogëlimin e ndikimit rus në vend dhe rajon është që SHBA-të dhe BE-ja të ndalojnë mundësimin dhe fuqizimin e Serbisë për të luajtur rolin e prishësit në rajon. Strategjia duket se synon që ta "tërheqë" Serbinë dhe që ajo ta braktisë Rusinë në këmbim të miliarda eurove të ndihmës financiare dhe zbutjes së Serbisë duke i dhënë rolin e vetos për zhvillimet në Kosovë, Bosnjë dhe Mal të Zi. Nëse "aftësia superiore krijon ambicie superiore",<sup>180</sup> secili koncesion i bërë ndaj Serbisë e ka afruar Rusinë në rajon dhe e ka zgjeruar ndikimin e saj. Serbia shërben si porta hyrëse për ndërhyrjen ruse në rajon dhe ka lejuar që populli i saj dhe infrastruktura e saj politike të jenë në dispozicion të Ruisë, duke shpresuar dhe duke pritur që mbështetja ruse t'i avancojë interesat e Serbisë në Kosovë, Bosnjë dhe Mal të Zi. Përkëdhelja nga SHBA-të dhe BE-ja nuk ka funksionuar për tridhjetë vjet, dhe nuk do të funksionojë as në të ardhmen. Me çdo koncesion në kurriz të Kosovës, Bosnjës dhe Malit të Zi, është zgjeruar hapësira ruse e manovrimit. Siç e kanë treguar dëshmitë, Rusia lulëzon në hapësira ku ekzistojnë konflikte të ngjira.

• **Së dyti**, SHBA-të janë në pozitë veçanërisht të mirë për t'i ndihmuar Kosovës duke e përgatitur për anëtarësimin në NATO. Anëtarësimi i Kosovës në NATO do të garantonte sigurinë e saj. Megjithëse kjo mund të konsiderohet si e perealizueshme për shkak të disa anëtarëve të NATO-s që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, SHBA-të kanë më shumë peshë në NATO se çdo shtet tjetër anëtar.

• **Së treti**, SHBA-të dhe NATO-ja kanë bërë një punë të jashtëzakonshme në profesionalizimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës. Ata duhet t'i edukojnë më tej, t'i trajnojnë, të bashkëpunojnë dhe të koordinojnë me organizatat e sigurisë së Kosovës për luftën hibride, duke përdorur praktikën më të mira nga shtetet baltike dhe Finlanda. Shtetet e Bashkuara mund të ndihmojnë edhe në krijimin e një "Komande Kibernetike" për FSK-në që të shërbejë si vija e parë e mbrojtjes kundër aktorëve shtetërorë ose të sponsorizuar nga shteti që përfshihen në sulme kibernetike.

180 Thënie nga Spock, një personazh TV/filmi në Star Trek.

• **Së katërti,** NATO-ja dhe BE-ja duhet të krijojnë një Qendër Rajonale të Ekselencës për Mbrojtjen Hibride me seli në Kosovë por me mision për të ndihmuar vendet e Ballkanit Perëndimor për t'i rezistuar ndikimit armiqësor. Meqenëse Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut janë anëtare të NATO-s dhe trupat e NATO-s janë në Kosovë, kjo do t'u shërbente interesave të NATO-s për të rritur aftësitë e vendeve anëtare në rajon, si dhe të Kosovës dhe Bosnjës.

• **Së pesti,** nën dritën e anëtarësimit të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut në NATO, politikëbërësit dhe studiuesit perëndimorë (në një farë mase) kanë qenë tepër optimistë se si ka ardhur fundi veprimit të lirë i Rusisë në rajon. Nëse nxirret ndonjë mësim nga zgjedhjet parlamentare të shtatorit 2020 në Malin e Zi (me partitë pro Serbisë/Rusisë që fituan shumicën), atëherë ky duhet të jetë se optimizmi i pashpresë është zëvendësues shumë i dobët i kujdesit. Humbjet e perceptuara taktike të Rusisë nuk duhet të keqinterpretohen si braktisje e fushës së betejës. Ekuilibri është shumë delikat mes forcave pro-NATO-s/BE-së dhe atyre pro-Rusisë në disa vende të rajonit, në të cilat vetëm një grusht votash në parlament i ndajnë të dy krahët. Komuniteti ndërkombëtar nuk duhet ta injorojë potencialin për një inkursion rus/serb në veriun e Kosovës, të ngjashëm me çka ndodhi në Krime. Edhe pse mund të duket se nuk ka gjasa për këtë lloj veprimi, janë të paktën disa zyrtarë të lartë ushtarakë që nuk mendojnë se nuk ia vlen të mbahen sytë hapur në këtë drejtim. Me kalimin e viteve, janë tretur edhe kapacitetet e KFOR-it në armatime dhe trupa ushtarake, të cilat tashmë nuk mjaftojnë për ta parandaluar agresionin e huaj, veçanërisht kthimin me forcë dhe në mes të natës të "paqeruajtësve" rusë në veriun e Kosovës në "mbrojtje të civilëve të pafajshëm serbë" nga "sulmet e institucioneve represive të Kosovës."







Katalogimi në botim – **(CIP)**  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

327(496.51:470)

Vllasi, Elis

Ndikimi Rus në Kosovë nën Hijen e Mitit dhe Realitetit / Elis Vllasi. – Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2020. – 39 f. ; 21 cm.

**ISBN 978-9951-799-12-6**

[www.qkss.org](http://www.qkss.org)

